

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6168  
E mërkurë, 18 nëntor 2020  
çmimi 0.40 €

## Kurthi i Dick Martyt

FAQE 6



Shkruan: Prof. Ass. Dr. Sabri KICMARI

Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

KUVENDI I KOSOVËS KA MBAJTUR SEANCË PLENARE LIDHUR ME MENAXHIMIN E  
SITUATËS ME PANDEMINË COVID-19



Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë debatuar të martën në një seancë plenare lidhur me menaxhimin e situatës me pandeminë Covid-19. Deputetët e

opozitës kanë thënë se situata me pandeminë është përkeqësuar dhe ka dalë jashtë kontrollit si pasojë e keqmenaxhimit që është duke bërë qeveria Hoti. Ndërkaq ministri i

Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se në rrethanat aktuale do të ishte mirë që të gjithë të bëhen bashkë për ta luftuar pandeminë Covid-19



## SEANCA E PARË STATUSORE: THAÇI, VESELI, KRASNIQI E SEIMI SOT BASHKË PARA SPECIALES


FAQE 4-5

Ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi do të dalin sot (e mërkurë) në orën 11:00 para gjyqtarit të procedurës

paraprake të Dhomave të Specializuara në Hagë. Në konferencën statusore sipas rregullores të pranishëm duhet të jenë edhe avokatët e të akuzuarve. Në

paraqitjen e parë para këtyre dhomave në Hagë, Thaçi, Veseli, Krasniqi e Selimi kanë thënë se akuzat ndaj tyre janë të pabaza, duke u deklaruar të pafajshëm për të gjitha pikat e akuzave

## KADAJ-BUJUPI KËRKON NGA QEVERIA QË TË NDAJË NJË PAKO NDIHMESË PËR GAZETARËT



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

### OPINION

#### MES MOSPËRFILLJES, KUSHTËZIMEVE DHE INJORANCËS (I)

F. 11

Shkruan:  
Agron HOTI



### AKTUALE



#### EDHE 16 TË VDEKUR DHE 690 RASTE TË REJA ME COVID NË KOSOVË

F. 7

#### GENT CAKAJ SHPALLET "QYTETAR NDERI" I BUJANOCIT

F. 2

#### VJOSA OSMANI INFEKTOHET ME COVID-19

F. 7

### EKONOMI



#### BQK-ja DHE BANKAT KOORDINOJNË VEPRIMET PËR TË NDIHMUAR EKONOMINË

F. 8

#### REÇICA ME BASHKËPUNIMIN KONKRET ME FMN-në PËR REFORMAT SOCIALE

F. 9

### SPORT

#### BIBLIOTEKA E QYTETIT TË MITROVICËS PASUROHET ME 800 EKZEMPLARË TË RINJ

F. 15

## Shkupi kundër bisedimeve me Sofjen për gjuhën dhe identitetin

**SHKUP, 17 NËNTOR-** Pavarësisht vetos së Bullgarisë për kornizën negociuese me Bashkimin Evropian, autoritetet maqedonase thonë se bisedime me Sofjen për gjuhën dhe identitetin maqedonas, nuk mund të ketë. Zëvendëskryeministri për çështje evropiane, Nikolla Dimitrov, është edhe arsyeja tjera që nuk do të ketë vendim, pasi për shkak të pandemisë, mbledhja e ministrave të Punëve të Jashtme të vendeve anëtare të BE-së mbahet online, andaj edhe protokollin e punës nuk lejohet marrjen e vendimeve. “Ne duam anëtarësimin në Bashkimin Evropian, duam t’i nisim bisedimet, por nuk bisedojmë dhe nuk mundemi të bisedojmë për atë se kush jemi dhe çfarë gjuhe flasim. Ne jemi maqedonas që flasim gjuhën maqedonase. Kjo është e drejtë e jona sovranë. Pasuritë gjuhësore janë një nga vlerat thelbësore të Bashkimit Evropian”, ka deklaruar Dimitrov në një prononcim për mediet, duke theksuar se

negociata të tilla nuk do të ketë as vitin e ardhshëm, e asnjëherë tjetër.

Ndërkohë, edhe të martën zyrtarët bullgarë kanë vazhduar me deklaratat kundër fillimit të bisedimeve mes Maqedonisë së Veriut dhe Bashkimit Evropian. “Për Maqedoninë e Veriut ka vend në Bashkimin Evropian, por kur t’i plotësojë kushtet. Për momentin ajo nuk i plotëson ato. Diplomacia bullgare nuk mund të lejojë që të ndjekë një politikë denigrimi të një vendi tjetër, të cilën, për fat të keq, e shohim në Shkup. Ne jemi një shtet anëtar i Bashkimit Evropian”, ka deklaruar shefja e diplomacisë bullgare, Ekaterina Zaharieva për televizionin kombëtar bullgar (BNT) para takimit ministror të BE-së në Bruksel.

Dështimi për nisjen e bisedimeve dhe kushtëzimet e palës bullgare kanë rritur tensionet mes pushtetit dhe opozitës në Maqedoni të Veriut. Kreu i partisë opozitare maqedonase, VMRO-DPMNE, Hristijan Mickovski, ka fajësuar qeverinë e kryeministrit Zoran Zaev, duke argumentuar se ka lejuar Bullgarinë jo vetëm të bllokojë procesin integruar, por edhe të “poshtërojë maqedonasit”.

“Nuk ka një maqedonas apo ndonjë qytetar tjetër që e ndjen



këtë vend si të vetin që të mos ndjehet i poshtëruar, i ofenduar nga të gjitha ato deklarata që populli ynë është artificial, se gjuha është një pemë pa rrënjë, por e shpikur në vitin e 1945, që luftëtarët tanë të shenjtë për liri ishin bullgarë dhe çfarë jo tjetër”, ka deklaruar Mickovski duke bërë të qartë se VMRO-ja nuk do të pranojë asnjë kompromis që asimilon popullin maqedonas.

“Unë i bëj thirrje Qeverisë së Zaevit të mbrojë interesat kombëtare dhe strategjike. Këto duhet të jenë prioritetet e saj, të

arrijë një zgjidhje jo me çmimin e vetëmohimit dhe fshirjes, një zgjidhje që do të garantojë identitetin tonë, gjuhën dhe që do të mundësonte nisjen e negociatave me BE-së”, ka theksuar Mickovski.

Lidhja Social Demokrate e kryeministrit Zaev, ka hedhur poshtë akuzat e opozitës duke i rikujtuar asaj “punën që është bërë në procesin e integritimit euroatlantik”. “Nëse Mickovski nuk e di, është mirë të dijë se Maqedonia e Veriut në këto tre vjet ka shënuar vetëm se fitore; ne arritëm lirinë, fituam një

shtet mik- Greqinë, arritëm të anëtarësohemi në NATO dhe arritëm të kemi një qeveri që respekton të gjitha komunitetet, arritëm që të sigurojmë gjuhën dhe identitetin tonë që njihen në të gjithë botën”, thuhet në reagimin e Lidhjes Social Demokrate.

Partitë politike shqiptare gjatë kësaj periudhe janë treguar të përmbajtura nga komentet me arsyetimin se bëhet fjalë për “çështje të ndjeshme”, andaj edhe thonë se nuk duan të keqinterpretohen.

## Gent Cakaj shpallet ‘Qytetar Nderi’ i Bujanocit

**BUJANOC, 17 NËNTOR-** Kuvendi Komunal në Bujanoc, i përkrahur nga iniciativa e 26 këshilltarëve shqiptarë kanë shpallur “Qytetar Nderi të Bujanocit”, ministrin në detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë, Gent Cakaj.

Kryetari i Kuvendit Komunal, Enver Ramadani ka lexuar iniciativën në fjalë, pas së cilës ka pasuar duartrokitje dhe ngritje në këmbë në shenjë respekti për kryediplomatit Gent Cakaj. “Sot është një ditë e shënuar për të gjithë qytetarët e Bujanocit. Mbështetja e tij e pashoqe për Komunën e Bujanocit dhe qytetarët e saj në fusha të ndryshme dhe bashkëjetësimit e vlerave proevropiane e bëjnë ‘Qytetar Nderi’ për nderin dhe respektin që i kushtoi një komune të vogël e krejt të harruar nga gjithë ata që kishin obligime institucionale për ta mbështetur. Duke pasur parasysh angazhimin dhe përpjekjet e tij për të

përmirësuar situatën ekonomike në komunën tonë, bashkëpunimin e pakushtëzuar në të gjitha fushat e tjera, besoj dhe jam i bindur se ministri Gent Cakaj është i denjë të jetë mbajtës i titullit ‘Qytetar Nderi’ i Komunës së Bujanocit. Duke nderuar personalitetet e profilit të lartë siç është ministri Gent Cakaj ne i ndërlidhim ata më shumë e më fort me qytetin dhe bashkëqytetarët tanë. Prandaj në emër të të gjithë këshilltarëve të nënshkruar në iniciativë, në emrin tim personal dhe në cilësinë e kryetarit të Kuvendit Komunal të Bujanocit ju ftoj që ta mbështesni dhe përkrahni këtë iniciativë dhe votoni këtë propozim-vendim”, është shprehur Ramadani në fjalën e mbajtur.

Pas këtij vendimi Kuvendi Komunal i Bujanocit, Ministria e Pushtetit Lokal të Serbisë duhet t’i japë dritën jeshile zyrtarizimit të kryediplomatit shqiptar, si qytetar nderi i kësaj komune.



Kuvendi i Kosovës ka mbajtur seancë plenare lidhur me menaxhimin e situatës me pandeminë Covid-19

## Opozita drejton kritika ndaj qeverisë për keqmenaxhim me pandeminë Covid-19

Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë debatuar të martën në një seancë plenare lidhur me menaxhimin e situatës me pandeminë Covid-19. Deputetët e opozitës kanë thënë se situata me pandeminë është përkeqësuar dhe ka dalë jashtë kontrollit si pasojë e keqmenaxhimit që është duke bërë qeveria Hoti. Ndërkaq ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se në rrethanat aktuale do të ishte mirë që të gjithë të bëhen bashkë për ta luftuar pandeminë Covid-19

**EPOKA  
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 17 NËNTOR-Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë debatuar të martën në një seancë plenare lidhur me menaxhimin e situatës me pandeminë Covid-19. Nënkrjetarja e Kuvendi të Kosovës nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Arbërie Nagavci ka thënë se situata me pandemi është përkeqësuar. Ajo ka theksuar se numri i madh i rasteve të të prekurve me virus dhe vdekjeve është alarmant. "Qeveria nuk garanton siguri dhe mbështetje për qytetarët. Logjika nga çka

udhëheqin qeveritarët tregon se barrën më të madhe e kanë hedhur te vetë qytetarët. Kërkohej prej tyre t'ia dalin si të mundën. Jemi në një krizë të shumanshme nga Covid-19. Situata është krejtësisht jashtë kontrollit", ka thënë ajo. Edhe deputetët e tjerë nga Lëvizja Vetëvendosje adresuan kritika ndaj Qeverisë së Kosovës të udhëhequr nga kryeministri Avdullah Hoti, për siç thanë, dështimin në menaxhimin e gjendjes me pandeminë Covid-19. Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se në rrethanat aktuale do të ishte mirë që të gjithë të bëhen bashkë për të luftuar

pandeminë. "Të gjithë ne do të jemi faqebardhë kur do ta largojmë virusin. Në këtë kohë duhet mobilizim e kurajë, e solidaritet pozitiv e opozitë. Secili ka mundësi të japë kontribut për t'u përballur me pandeminë", ka thënë ministri Zemaj, duke shtuar se në harmoni me ligjin janë hartuar edhe plane. Ai ka bërë me dije se brenda disa ditëve do të arrijnë në Kosovë rreth 160 mijë vakcina kundër gripit sezonal. Zemaj u shpreh se këtë vit ka rritje mbi 60 për qind të sasisë së këtyre vaksinave. Edhe deputeti Bekim Haxhiu, nga partia tjetër opozitare, Partia Demokratike e Kosovës

ka thënë se situata është "buzë kolapsit". Ai ka thënë se duhet të sigurohet aparaturë e re në spitale dhe të rritet numri i testeve në grupe. "Sot nuk mund të flasim për menaxhimin e pandemisë Covid-19, por për keqmenaxhimin e saj, paafësi, mosshfrytëzim të të gjitha kapaciteteve shëndetësore, në këtë përballje me koronavirusin. Sot situata me pandemi është buzë kolapsit", ka thënë Haxhiu. Edhe deputetja tjetër e PDK-së, Evgjëni Thaçi-Drăgusha ka theksuar se Kosova po përballlet me katastrofë humanitare dhe se pandemia Covid-19 është jashtë kontrollit. Ajo ka pohuar se qeveria nuk do të mund ta përballojë menaxhimin e pandemisë Covid-19. "Jemi duke u përballur me një situatë, që mund ta quajmë lirishit një katastrofë humanitare. Kemi humbje të mëdha njerëzore, kemi humbje materiale-ekonomike e të cilat ne si vend dhe kjo qeveri me

këto resurse dhe me këtë plan që ka në dispozicion nuk mund ta përballojë. Prandaj, kjo gjendje kërkon vëmendjen e të gjithë neve", ka thënë ajo. Deputet i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Ekrem Hyseni, ka folur në emër të Grupit Parlamentar të kësaj partie, duke thënë se nuk duhet të kërkohej fajtor i vetëm në një situatë me pandemi. Ai ka thënë se Covid-19 e ka gjuhëzuar botën. "Ne duhet të jemi pro masave të cilat e vënë nën kontroll pandeminë. Dhe përkundër nevojës për masa, duhet të ruhet edhe ekonomia. Atë e ruajmë kur bëjmë një balancë të të gjitha aktiviteteve ekonomike në vend, por duke e parë si prioritet shëndetin e popullatës", ka thënë ai. Kurse deputetja e AAK-së, Albena Reshitaj ka theksuar se sot mund të kërkohej përgjegjësi nga ministri, por sipas saj, duhet të shikohen segmentet e tjera, duke përmendur mosmiratimin e Ligjit për rimëkëmbje ekonomike.



## Mbahet Konferenca për Migracion në Vjenë

PRISHTINË, 17 NËNTOR (ER)-Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Yildiray Bayram, njëherësh Koordinator Nacional për Migrim, mori pjesë në Konferencën për Migracion në Vjenë (VMC). Konferenca e Migracionit në Vjenë është ngjarja kryesore vjetore e Qendrës Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikave të Migracionit (ICMPD) për diskutimin e çështjeve më sfiduese dhe të rëndësishme politikisht në

fushën e migracionit. Në këtë konferencë të mbajtur në platformën online, përveç zëvendësministrit të MPB-së, Yildiray Bayram, morën pjesë vendimmarrës politikë, ekspertë të qeverive dhe përfaqësues nga bota akademike, media dhe shoqëria civile. Gjatë kësaj konference u diskutuan edhe çështje të tjera rreth pandemisë Covid-19, të cilat po ndikojnë në gjithë botën.





# SEANCA E PARË STATUSORE: THAÇI, VESELI, KRASNIQI E SELIMI SOT BASHKË PARA SPECIALES

Ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi do të dalin sot (e mërkurë) në orën 11:00 para gjyqtarit të procedurës paraprake të Dhomave të Specializuara në Hagë. Në konferencën statusore sipas rregullores të pranishëm duhet të jenë edhe avokatët e të akuzuarve. Në paraqitjen e parë para këtyre dhomave në Hagë, Thaçi, Veseli, Krasniqi e Selimi kanë thënë se akuzat ndaj tyre janë të pabaza, duke u deklaruar të pafajshëm për të gjitha pikat e akuzave

**EPOKA E RE****Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 17 NËNTOR- Konferenca e parë statusore për katër anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, do të mbahet sot (e mërkurë). Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi do të dalin para gjyqtarit të procedurës paraprake të Dhomave të Specializuara në Hagë, në orën 11:00.

Në konferencën statusore, të pranishëm duhet të jenë edhe avokatët e të akuzuarve. "Gjykatësi i procedurës paraprake thirr një konferencë mbi ecurinë e çështjes sa më shpejt që të jetë e mundshme, pas paraqitjes së parë të të akuzuarit", thuhet në Rregulloren e Procedurës dhe Provave të Dhomave të Specializuara të Kosovës. Ish-drejtori politik i UÇK-së, Hashim Thaçi, dhe ish-

zëdhënësi i UÇK-së, Jakup Krasniqi, kanë hedhur poshtë pretendimet e Dhomave të Specializuar për krime lufte ndaj tyre.

Në paraqitjen e parë para këtyre dhomave në Hagë, Thaçi dhe Krasniqi kanë thënë se akuzat ndaj tyre janë të pabaza. "Deklarohem i pafajshëm për të gjitha pikat e akuzës", ka deklaruar Thaçi kur është pyetur nga gjykatësi i procedurës paraprake nëse

ndihet i pafajshëm apo fajtor rreth aktakuzës për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Ai e ka deklaruar se aktakuzat kundër tij janë të paqëndrueshme.

Njëjtë është deklaruar edhe ish-zëdhënësi i UÇK-së, Jakup Krasniqi, i cili është paraqitur në seancë paraditen e së hënës. "Unë nuk ndihem fajtor e as përgjegjës për asnjë pikë që thuhet në aktakuzë dhe për asnjë gjë tjetër që thuhet në aktakuzë", ka deklaruar Krasniqi gjatë paraqitjes së parë para Dhomave të Specializuara, kur është pyetur nëse deklarohet i pafajshëm apo fajtor për krimet që rëndojnë ndaj tij.

Krasniqi, para se të deklarohet për aktakuzën, mbajti një fjalim para gjykatës, ku ka deklaruar se është bërë një padrejtësi e madhe ndaj tij. "Cilësimi i prokurorit të Dhomave të Specializuara, se

ne qenkemi ndërmarrje kriminale e përbashkët, për mua, shokët e mi, familjen time që luftuam gjatë, por edhe për kombin tonë, nuk ka diçka më fyese, pasi në një kohë të gjatë, në rrethana tepër të vështira jetë a vdekje, u vumë në shërbim të lirisë e të shtetndërtimit të cilat i arritëm në bashkëveprim me Shtetet e Bashkuara, me vendet e Bashkimit Evropian, me NATO-n, me OKB-në dhe të gjithë së bashku ishim dhe jemi ndërmarrje e përbashkët çlirimtare dhe shtetformuese", ka deklaruar Krasniqi gjatë një fjalimi para Gjykatës në Hagë. Ai ka vlerësuar se ndërmarrje e përbashkët kriminale është koka e Beogradit dhe mbështetësit e politikës së Beogradit.

Edhe ish-anëtari i Shtabit të Përgjithshëm i UÇK-së, Kadri Veseli, është deklaruar i pafajshëm për akuzat e

Dhomave të Specializuara në Hagë. Në paraqitjen e parë para kësaj gjykate, ai ka thënë se me bindje të plotë mohon të gjitha pikat e aktakuzës së ngritur ndaj tij. “I nderuar gjykatës, i dëgjova dhe i kam lexuar të gjitha pikat e aktakuzës. Më lejoni të deklaroj me bindje të plotë, se jam i pafajshëm në të gjitha pikat e aktakuzës”, ka deklaruar Veseli.

Avokati i Veselit, Ben Emmerson, ka treguar se Veseli është paraqitur në Hagë vullnetarisht, duke shtuar se do

ta kërkojë lirimin e tij të parakohshëm.

Po ashtu edhe ish-eprori i lartë i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Rexhep Selimi, është deklaruar i pafajshëm për aktakuzën për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, që është konfirmuar ndaj tij nga Dhomat e Specializuara në Hagë. Në paraqitjen e parë para Gjykatës Speciale, Selimi ka mohuar të gjitha pikat e aktakuzës. “Unë deklaroj i pafajshëm për të gjitha pikat e aktakuzës”, ka thënë Selimi, kur

është pyetur që të deklarojë nëse ndihet i pafajshëm apo fajtor për akuzat që rëndojnë ndaj tij. Para se ta deklarojë pafajësinë, ai në fjalën e tij ka kundërshtuar aktakuzën duke e quajtur të padrejtë.

Ish-shefi i grupit parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje ka treguar edhe arsytet se pse kishte kundërshtuar themelimin e kësaj gjykate. “Sot këtu nuk jam si deputet që e kam kundërshtuar këtë gjykatë, por si ish-ushtar i UÇK-së, themelues i saj, përballë një aktakuze të

ngritur nga Prokuroria dhe ju z. gjykatës. Rolet këtu i kemi të ndara, jemi palë të ndryshme por, ju lutem, më bëni të besoj se, po ashtu, qëllimi ynë do të jetë drejtësia, mbi të gjitha e vërteta. E pashë aktakuzën e ngritur nga Prokuroria. Ishte aktakuzë e rëndë, vuliminoze, e padrejtë, e pasaktë ndaj meje dhe luftës së popullit tim dhe shtetit nga vij unë”, ka deklaruar Selimi, duke shtuar se fundi i këtij procesi do ta dëshmojë luftën e drejtë të UÇK-së.

Konfirmimi i aktakuzave për

Thaçin, Veselin, Krasniqin dhe Selimin ka nxitur reagime të shumta në Kosovë dhe në Shqipëri. Liderë politikë dhe bashkëluftëtarë të tyre kanë dalë në krahë të ish-udhëheqësve të UÇK-së, duke besuar fuqishëm në pafajësinë e tyre.

Dhomat e Specializuara konfirmuan aktakuzën ndaj Thaçit, Veselit, Krasniqit dhe Selimit më 26 tetor, por ajo u bë publike më 5 nëntor. Ndaj tyre rëndojnë akuza për krime lufte.



# POLICIA NIS HETIMET PAS DJEGIES SË BILBORDIT NË GRAÇANICË

**GRAÇANICË, 17 NËNTOR-** Në Kishnicë, e cila gjendet në territorin e Komunës së Graçanicës, është djegur një billboard me mbishkrimin “Liria ka Emër, UÇK”.

Këtë e ka konfirmuar për “Radion Evropa e Lirë”, komandanti i Stacionit të Policisë në Graçanicë, Bratislav Trajkoviç.

“Ekipet e policisë janë në vendin e ngjarjes dhe hetimet po vazhdojnë”, tha ai.

Kishnica që gjendet në magjistralen Prishtinë-Gjilan, është e banuar me shumicë shqiptare, mirëpo bën pjesë në territorin e Graçanicës, e cila është njëra ndër dhjetë komunat me shumicë serbe në Kosovë.

Kryetar i saj është Sërgjan

Popoviç nga Lista Serbe, partia më e madhe e serbëve të Kosovës.

Popoviç më 16 nëntor kishte kërkuar heqjen e billboardit “Liria ka emër, UÇK” në Kishnicë, pasi sipas tij, “banorët e Graçanicës ishin të shqetësuar”.

Popoviç pati thënë se “për incidentin e fundit ka biseduar me përfaqësuesit e policisë dhe

se pas takimit raporti i policisë për këtë ngjarje do t’i dërgohet Ministrisë së Transportit, pasi ajo është pronare e tokës ku është vendosur billboardi”.

Megjithatë, komandanti i Stacionit Policor në Graçanicë, Bratislav Trajkoviç, pohon se takimi me Popoviçin nuk ishte mbajtur, dhe as që ka pasur një kërkesë për takim të tillë.

Bilbordet me mbishkrimet “Liria ka Emër” janë vendosur në shumë pjesë të Kosovës, në kuadër të një fushate mbështetjeje ndaj ish-udhëheqësve të lartë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ndaj të cilëve Gjykata Speciale në Hagë ka ngritur aktakuzë për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

# Kurthi i Dick Martyt



Shkruan: Prof. Ass. Dr. Sabri KİÇMARI

Në raportin e tij, që mban datën 7 janar 2011, Dick Marty konstaton se “në periudhën fill pas përfundimit të konfliktit të armatosur, përpara se forcat ndërkombëtare të merrnin në dorë kontrollin e rajonit dhe të vendosnin rendin e ligshmërinë, organe të trupit u janë marrë disa robërve në një klinikë në territorin shqiptar, pranë Fushë-Krujës, për t’u transportuar më pas jashtë shtetit për qëllime transplantimi”.

Ky formulim makabër, që vret ndërgjegjen e secilit njeri racional, ndikoi që më 25 janar 2011 të aprovohej në formë të rezolutës raporti i Dick Martyt në Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës. Ky formulim ishte në fakt një kurth, në të cilin ra Këshilli i Evropës.

Nuk është e rastësishme që ky raport u soll për aprovim gjashtë muaj pas Opinionit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, e cila më 22 korrik 2010 kishte konstatuar se akti i shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, më 17 shkurt 2008, është në akord me të drejtën ndërkombëtare. Serbia u gjend në një gjendje dëshpëruese pas Opinionit të Gjykatës së Hagës. Në një gjendje të tillë dëshpëruese për humbjen e betejës juridike, e cila ishte pasuar nga humbja diplomatike në Këshillin e Sigurimit, ku ishte insistuar që OKB-ja ta shpallte jolegal aktin e shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës, diplomacia serbe dhe ruse në marrëveshje me kundërshtarin e pavarësisë Dick Marty sollën në Këshillin e Evropës raportin në fjalë. Duket se e kishin pritur rastin e volitshëm për të bërë këtë gjë. Si rrjedhim i Rezolutës së Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës BE-ja formoi Task Forcën Hetimore Speciale, kurse Kuvendi i Kosovës, më 3 gusht 2015, aprovoi Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar si dhe aprovoi nenin 162 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Në fakt, menjëherë pas shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës ish prokurorja Carla Del Ponte në librin e saj “Gjuetia: Unë dhe kriminelët e luftës” ndër të tjera

supozonte se ka pasur trafikim të organeve të të burgosurve serbë nga ana e pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Mbi bazën e kësaj, në prill të viti 2008, deputeti rus në Këshillin e Evropës Konstantin Kosachev inicoi një rezolutë për “trajtimin çnjerëzor të personave dhe tregtinë ilegale me organet e njerëzve”. Propozimi i deputetit rus u përkrah nga deputeti serb Milos Aligrudiq dhe 15 deputetë të tjerë, shumica prej të cilëve nga Evropa e Lindjes (Federata Ruse, Gjeorgjia, Ukraina, Aserbeixhani, Polonia dhe Hungaria). Komisioni për Çështje Juridike dhe të Drejtat e Njeriut i Këshillit të Evropës emëroi Dick Martyt si raportues, një ekspert i hapur kundër bombardimeve të Serbisë në vitin 1999 dhe kundër shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës në vitin 2008.

Marty nuk e solli raportin e tij përgjatë vitit 2008 dhe 2009. Kjo nuk ishte e rastësishme. Hartuesit e strategjisë serbe, të mbështetur nga diplomacia ruse, shpresonin që Opinionin i Gjykatës Ndërkombëtare, nëse nuk do të ishte kundër shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës, të paktën do të kishte formulime ambivalente, të cilat do të mund të interpretoheshin dyanshëm. Vendimi i qartë dhe pa ambiguitet i 22 korrikut 2010 të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në favor të legalitetit dhe legjitimitetit të shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës e solli në gjendje dëshpëruese politikën dhe diplomacinë serbe. Duket se një rast i tillë ishte pritur edhe nga deputeti Dick Marty. Vetëm gjashtë muaj pas Opinionit të Gjykatës Ndërkombëtare ai do të dorëzonte raportin e tij, i cili përmbante një gjuhë urrejtjeje jo vetëm për UÇK-në, por edhe për etnopsikologjinë shqiptare. Politika e Kosovës nuk e përballoi dot presionin e partnerëve ndërkombëtar për të miratuar Gjykatën Speciale. Akterët politikë që kanë komunikuar me ShBA-të, Mbretërinë e Bashkuar, Gjermaninë, Francën dhe vendet e tjera të BE-së nuk u treguan të shkathtë për të argumentuar demin që i shkaktohej vendit dhe iracionalitetin e krijimit të një gjykate të tillë. Fakti se disa nga akterët që komunikojnë me ndërkombëtarët ishin përmendur vetë në raportin e Dick Martyt vetëm e komplikonte mundësinë për t’u marrë seriozisht argumentet e tyre. Kërcënimi i diplomatëve të vendeve mike se në rast se nuk aprovohej krijimi i Gjykatës nga Kosova, ata nuk do të përdornin të drejtën e vetos në Këshillin e Sigurimit për krijimin e një

gjykate të tillë nga OKB-ja vetëm e shpjegon gjendjen absurde në të cilën u gjend vendi ynë.

Dhe, ndodhi ajo që pritej të ndodhte pas krijimit të Gjykatës Ndërkombëtare. Prokuroria Speciale ngriti aktakuzën. Në Aktakuzën e ngritur nga Prokuroria Speciale, që mban datën 4 nëntor 2020, nuk është përfshirë akuza për trafikimin e organeve. Duket qartë se ajo është përdorur vetëm si një mjet për të arritur efektet psikologjike të anëtarët e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës dhe të institucionet e Bashkimit Evropian. Në vend të akuzës për trafikim të organeve, Gjykata Speciale dha urdhër për arrestimin e katër anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit), me akuzën për krime kundër njerëzimit dhe krime lufte.

Teksti i aktakuzës është i strukturuar në atë mënyrë që e merr parasysh edhe historinë politike dhe kontekstin e rrethanave të ngjarjeve të viteve 1998-1999. Në rrafshin kontekstual kohor në aktakuzë përfshihet periudha në mes të marsit 1998 dhe shtatorit të vitit 1999, kurse në rrafshin geografik përfshihet i gjithë territori i Kosovës dhe dy zona në Shqipërinë Veriore. Prokuroria konstaton se ka pasur një “konflikt të armatosur ndërmjet UÇK-së dhe forcave të RFJ-së dhe Republikës së Serbisë”. Prokuroria e kualifikon UÇK-në si “një grup i armatosur i organizuar, me një shkallë të mjaftueshme organizimi për të mbajtur nën kontroll territor dhe për të planifikuar dhe kryer sulme të armatosura të bashkërenduara si dhe operacione të tjera ushtarake sulmuese dhe mbrojtëse”. Më tej prokuroria konstaton se “UÇK-ja kishte një Shtab të Përgjithshëm, ishte e organizuar në (nën)zona operative dhe lëshonte deklarata politike dhe komunikata në të cilat parashtronte politikën e saj”. Pra, prokuroria e konsideron me të drejtë UÇK-në si palë në konfliktin e armatosur në Kosovë ndërmjet saj dhe forcave të RFJ-së. Fakti se UÇK pranohet si palë në konfliktin e armatosur e delegjitimon akuzën e prokurorisë për “arrestime ilegale”.

Prokuroria nuk i ka akuzuar të arrestuarit si individ që kanë kryer krime. Ata janë kualifikuar si “ndërmarrje e përbashkët kriminale”. Askund prokuroria nuk fokusohet në qëllimin themelor të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që ishte çlirimi i vendit, por të akuzuarit ngarkohen se kishin qëllimin e

përbashkët “për të siguruar dhe ushtruar kontroll mbi të gjithë Kosovën përmes metodave që përfshinin frikësimin, keqtrajtimin, ushtrimin e dhunës dhe eliminimin e paligjshëm të atyre që konsideroheshin si kundërshtarë”. Prokuroria nuk flet për parimin themelor të UÇK-ës që ishte mospërdorimi i formave terroriste të veprimit dhe ndalimi i çdo lloj sulmi mbi civilët e pafajshëm. Në vend të kësaj ajo konstaton se “objekt sulmi i tyre ishin bashkëpunëtorët e institucioneve shtetërore të RFJ-së, personat që nuk mbështetnin qëllimet ose metodat e UÇK-së dhe më vonë të QPK-së, persona të lidhur me LDK-në dhe serbë, romë dhe persona të kombësive të tjera”. Dhe, më e qartë kjo gjë bëhet e ditur, kur fillon renditja e anëtarëve të grupit në pikën 35 të aktakuzës: përpos katër anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm, fillimisht përmenden me emër edhe disa pjesëtarë të tjerë dhe më pas numërohen edhe “udhëheqës të tjerë politikë dhe ushtarakë të UÇK-së dhe QPK-së, ministra dhe zëvendësministra të QPK-së, komandantë të zonave të UÇK-së, zëvendëskomandantë të zonave dhe anëtarë të tjerë të shtabeve të komandave të zonave, komandantë të brigadave dhe njësiteve, komandantë dhe anëtarë të shërbimeve policore dhe të zbulimit të UÇK-së dhe QPK-së, ushtarë të tjerë të UÇK-së dhe zyrtarë të tjerë të QPK-së, si dhe të tjerë që vepronin në emër të UÇK-së dhe QPK-së”. Ky formulim sinjalizon qartë secilin lexues të aktakuzës se fjala nuk është për një akuzë kundër individëve të veçantë, siç supozohej nga mbështetësit e idesë për krijimin e Gjykatës Speciale, por fjala është për një aktakuzë kundër gjithë strukturës komanduese të UÇK-së dhe njësiteve të saj. Është interesant se akuza kundër Hashim Thaçit dhe Jakup Krasniqit dallon për një pikë nga ajo kundër Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit. Dy të parët kanë tetë pika të aktakuzës, kurse dy të fundit shtatë. Thaçi dhe Krasniqi akuzohen edhe se kanë qenë të përfshirë në përpjekje “për të dhënë informata të rreme, të paplota dhe çorientuese komunitetit ndërkombëtar, vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikut”. Ky formulim dëshmon se prokuroria është shërbyer fort me të dhënat serbe. Prapa kësaj akuze qëndron një prapavijë djallëzore për të vënë nën akuzë edhe komunitetin ndërkombëtar se goja ai është manipuluar me të dhëna nga pjesëtarët e UÇK-ës dhe si rezultat i kësaj ka ndërhyrë

përmes sulmeve të NATO-s. Natyrisht që një akuzë e tillë është e padrejtë. NATO dhe akterët tjerë të Bashkësisë Ndërkombëtare kanë pasur një numër të madh mundësish për të verifikuar të dhënat e përfaqësuesve të UÇK-së dhe ata i kanë marrë të mirëqena ato vetëm pas verifikimit të tyre.

Krimet që ju ngarkohen të akuzuarve nuk janë të reja. Të gjitha këto akuza të renditura në kuadrin e krimit kundër njerëzimit ose krimit të luftës janë trajtuar edhe më parë. Sipas prokurorisë ka ndodhur burgosje/arrestim dhe ndalim i paligjshëm ose arbitrar në Likoc, Jabllanicë, Llapushnik, Drenoc, Malishevë, Bare, Bajgorë, Llapashticë, Zllash, Kleçkë, Ferizaj, Gjilan, Suharekë, Novobërdë, në Kosovë si dhe në Cahan dhe Kukës në Shqipëri. Por, të gjitha këto raste janë trajtuar tashmë nga Gjykata për Krime Luftë në ish-Jugosllavi, nga gjykatat e UNMIK-ut dhe EULEX-it. Janë gjyqe të zhvilluara në Hagë dhe Kosovë, të cilat kanë përfunduar tashmë dhe të akuzuarit janë liruar. Janë trajtuar me vite ish-kryeministri Haradinaj, deputeti Limaj, komandantët e zonave të Llapit dhe Drenicës për të gjitha këto raste dhe të gjithë janë liruar tashmë.

Kosova është dëmtuar rëndë me krijimin e Gjykatës Speciale. Shoqëria dhe shteti i Kosovës duhet të jenë të vetëdijshme për këtë fakt. Tani duhet përballur me dinjitet kundër një akuze të padrejtë ndaj luftës sonë çlirimtare. Nuk është fjala këtu për mbrojtjen e individëve të veçantë dhe as për amnistimin për gabimet e shumta politike gjatë qeverisjes së tyre në të kaluarën e afërt. Fjala është për mbrojtjen e dinjitetit të luftëtarit të lirisë, luftës sonë të drejtë për liri dhe pavarësi.

Institucionet shtetërore, politike dhe shoqërore duhet të jenë bashkë në mbrojtjen e drejtësisë së luftës në dy drejtime themelore: juridike dhe politike. Mbrojtja juridike bëhet nga avokatët mbrojtës të të akuzuarve, të cilët duhet pajisur me informacione të duhura për të vërtetën që ka ndodhur në Kosovë. Mbrojtja politike duhet bërë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Kuvendi i Kosovës, të gjitha institucionet shtetërore, partitë politike dhe shoqëria civile. Nuk mjaftojnë deklaratimet në “Facebook” dhe “Twitter” të zyrtarëve të Qeverisë. Duhet angazhuar ekspertë, përgatitur dokumente faktike dhe informuar diplomacinë dhe opinionin publik ndërkombëtar për atë që ka ndodhur në Kosovë në vitet 1998-1999. Kjo duhet bërë për hir të së tashmes dhe sidomos të së ardhmes së vendit tonë.

# Edhe 16 të vdekur dhe 690 raste të reja me Covid në Kosovë

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKShPK) ka njoftuar të martën se gjatë 24 orëve të fundit 16 pacientë kanë vdekur si pasojë e Covid-19 dhe janë regjistruar 690 raste të reja me këtë virus. Numri i rasteve të reja ka dalë pas testimit të 1.566 mostrave. Sipas të dhënave të fundit, numri i përgjithshëm i viktimave nga Covidi ka arritur në 849

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 NËNTOR- Gjatë 24 orëve të fundit, në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë me metodën RT-PCR, janë testuar gjithsej 1.566 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve kanë rezultuar 690 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar 16 raste të vdekjes me Covid-19. Rastet e vdekjes janë nga komunat: Gjakovë dy raste (78, 76 vjeç), Prishtinë dy raste (68, 65 vjeç), Prizren dy raste (72, 69 vjeç), Rahovec dy raste (55, 53 vjeç), Dragash një rast (76 vjeç), Ferizaj një rast (75 vjeç), Gjilan një rast (65 vjeç), Kamenicë një rast (75 vjeç), Mitrovicë një rast (60 vjeç), Pejë një rast (67 vjeç), Podujevë një rast (41 vjeç), Suharekë një rast (82 vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 30.495 raste nga 122.377 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 849 raste të vdekjes.

Gjatë 24 orëve të fundit, janë shëruar 337 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 17.878 raste, kurse numri i rasteve aktive është 11.768. Rastet pozitive janë nga

Komuna Prishtinë 277 raste, Gjilan 64 raste, Podujevë 59 raste, Gjakovë 55 raste, Pejë 40 raste, Ferizaj 27 raste, Fushë-Kosovë 25 raste, Viti 23 raste, Prizren 19 raste, Suharekë 16 raste, Lipjan 13 raste, Deçan 11 raste, Klinë 11 raste, Kamenicë 7

raste, Drenas 6 raste, Dragash 5 raste, Shtime 5 raste, Istog 4 raste, Mitrovicë 4 raste, Obiliq 4 raste, Rahovec 4 raste, Vushtrri 3 raste, Kaçanik 2 raste, Malishevë 2 raste dhe me nga 1 rast Komunat Hani i Elezit, Kllokot, Novobërdë dhe Skenderaj.

## Vjosa Osmani infektohet me Covid-19



PRISHTINË, 17 NËNTOR (ER)- Ushtruesja e detyrës së presidentes, njëherësh edhe kryetare e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani ka rezultuar pozitiv me Covid-19. Lajmin e ka bërë me dije vet Osmani përmes një postimi në llogarinë e saj në "Facebook". "Pasi disa të afërm me të cilët kisha kontakt rezultuan pozitivë në testin për Covid-19, u testova në IKSHKP dhe pak më parë u njoftova se edhe unë kam rezultuar pozitiv. Në dy javët e ardhshme do të punoj nga shtëpia, duke u kujdesur që secili dokument a vendim që kërkon shqyrtim e

vendimmarrje dhe që lidhet me përgjegjësitë e mia në të dy funksionet shtetërore që i ushroj, të trajtohet në kohë. Po ashtu, një numër takimesh do t'i vazhdoj nëpërmjet platformave elektronike", ka shkruar Osmani. Ajo ka thënë se përkundër kujdesit maksimal, po shihet që këto ditë virusi është kudo, më i përhapur se kurrë më parë, njëjtë i rrezikshëm si çdoherë. "Prandaj, uroj që ta tejkalojmë këtë sfidë bashkërisht, duke mos e injoruar rrezikun nga virusi dhe kujdesin që duhet treguar. Mirëmbetshi e shëndet të gjithëve", ka shkruar Osmani.

## Kadaj-Bujupi kërkon nga qeveria që të ndajë një pako ndihmesë për gazetarët

PRISHTINË, 17 NËNTOR (ER)- Deputetja e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Donika Kadaj-Bujupi, në seancën e së martës të Kuvendit të Kosovës lidhur me menaxhimin e situatës me pandeminë Covid-19, ka ngritur si shqetësim mospërkrahjen nga institucionet për gazetarët, të cilët, sipas saj, janë në vijën e parë të frontit me Covid-19. Ajo ka thënë se Qeveria duhet të ndajë një pako përkrahëse

për gazetarët. Kadaj-Bujupi ka thënë se gazetarët nuk kanë pasur përkrahje institucionale. "Ata janë të rrezikuar dhe shumë prej tyre janë infektuar. Gazetaria është profesion i rrezikshëm", ka thënë ajo, duke shtuar se gazetarët në këtë kohë të pandemisë janë duke dhënë kontributin e tyre, sikurse që po japin punëtorët shëndetësor, policia dhe shumë punëtorë të sektorëve të tjerë.



# Arrihet marrëveshje, zhbllokohen llogaritë e Telekomit të Kosovës

PRISHTINË, 17 NËNTOR (ER)- Janë zhbllokuar xhironlogaritë e Telekomit të Kosovës, pas një marrëveshje të arritur mes kësaj kompanie, Qeverisë së Kosovës dhe kompanisë Dardafon.

Marrëveshja është arritur pas ndërmjetësimit dhe garancionit të Qeverisë. "Kjo marrëveshje për shlyerjen e borxheve ndaj Dardafon garanton funksionimin normal të korporatës pa pasur brengën se llogaritë mund të bllokohen dhe zbrazen përsëri. Në bazë të kësaj marrëveshjeje Telekomit obligohet që brenda 24 muajve duke filluar nga 15 janari i vitit 2021 të shlyej komplet borxhin ndaj Dardafon, që është si rezultat i vendimit final të Gjykatës së Arbitrazhit dhe njohjes së këtij vendimi edhe nga gjykata vendore", thuhet në njoftimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit.

Me këtë marrëveshje, borxhi i konfirmuar nga organet e drejtësisë do t'i paguhet operatorit privat në një periudhë disavjeçare, dhe nuk do të ketë më bllokim të llogarive nga përmbaruesit privatë. "Kjo marrëveshje për zhbllokim të llogarive do të përcillet edhe nga një Marrëveshje Mirëkuptimi për Subvencionim të Kushtëzuar për Investime në operacionet vitale mes Qeverisë së Kosovës dhe Telekomit", thuhet në

njoftimin e Ministrisë.

Të hënën, Punëtorët e Telekomit të Kosovës protestuan para objektit të qeverisë, duke kërkuar zhbllokimin e xhironlogarive të kompanisë, pasi ende nuk i kanë marrë pagat e muajit tetor.

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave të Lirive të Njeriut (KMDLNj), ka theksuar se marrëveshja për zhbllokimin e xhironlogarive të Telekomit të garantohej nga Qeveria e Kosovës. "KMDLNj përkrahë kërkesat e drejta të punëtorëve të Telekomit sepse janë në mandatin e KMDLNj-së për mbrojtjen e të drejtave të njeriut e që me bllokimin e xhironlogarisë seriozisht u rrezikuan, duke i rrezikuar punëtorët dhe familjet e tyre. Shteti i Kosovës duhet të garantojë dhe sigurojë mirëqenien e qytetarëve, në



situata normale kurse, në situata jashtëzakonshme, së paku për pranojmë i ngjet situatave në të jashtëzakonshme duhet të t'ua lehtësuar gjendjen e cila, gjendje luftime", thuhet në merr vendime të deshëm apo nuk deshëm ta njoftimin e KMDLNj-së.

## Pse ishin të bllokuara xhironlogaritë e Telekomit?

Një marrëveshje e vitit 2009 me "Dardafon.net LLC", i kishte mundësuar kompanisë "Z-Mobile" të ishte operator virtual i telefonisë mobile të operatorit mobil Vala, që funksionon në kuadër të Telekomit të Kosovës. Mospajtimet mes palëve kishin nisur kur "Z-Mobile" ka kërkuar numeracion shtesë.

Çështja kishte shkuar në Arbitrazh dhe më pas Gjykata e Prishtinës kishte vendosur në

favor të kompanisë "Z-Mobile". Kontrata në vazhdimësi është konsideruar si e dëmshme, por si e tillë ka zgjatur deri në korrik të vitit 2019, kur bordi i Telekomit të Kosovës pati marrë vendim për shkëputjen e saj. Dardafon përmes përmbaruesit i bllokojë xhironlogaritë e Telekomit, pasi borxhi kishte arritur vlerën e mbi 25 milionë eurove.

Më 11 nëntor Besnik Krasniqi nga Ministria

e Ekonomisë tregon se "Z-Mobile", deri më tani ka arritur të marrë 6 milionë euro nga llogaritë e Telekomit.

Telekomi i Kosovës është ndërmarrje publike, e transformuar në shoqëri aksionare, në të cilën operon telefonia fikse dhe ajo mobile Vala.

Operatori Vala ka mbi 1.2 milionë konsumatorë në nivel vendi. Mbi 2,300 është numri i punonjësve në këtë kompani.

## BQK-ja dhe bankat koordinojnë veprimet për të ndihmuar ekonominë

PRISHTINË, 17 NËNTOR (ER)- Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, dhe zëvendësguvernatori Sokol Havolli kanë mbajtur një takim virtual me drejtuesit e Shoqatës së Bankave të Kosovës dhe përfaqësuesit e bankave komerciale në Kosovë. Temë e diskutimit në këtë takim, ishte gjendja aktuale në sektorin bankar dhe kontributi i këtij sektori në tejkalimin e gjendjes së krijuar, sidomos pas masave të reja. Guvernatori Mehmeti ka thënë se BQK-ja është e angazhuar në krijimin e të gjitha

mundësive për të ndihmuar qytetarët dhe bizneset, por në të njëjtën kohë të mbajë stabil dhe likuid sektorin bankar, siç ka qëndruar gjatë gjithë kësaj kohe, pavarësisht sfidave të shumta që solli pandemia.

Nga ana tjetër, përfaqësuesit e bankave shprehën gatishmërinë që të ndihmojnë në tejkalimin e kësaj situatë dhe në përkrahjen e ekonomisë së vendit, që pavarësisht se prioriteti i vendit mbetet ruajtja e shëndetit publik, një rëndësi të madhe ka edhe ruajtja e shëndetit të ekonomisë.



## Kuçi premtion kompletimin e bordit të ARKEP-it

PRISHTINË, 17 NËNTOR (ER)- Në Komisionin për Ekonomi është miratuar në parim Projektligji për masat për uljen e kostos së shtrirjes së rrjeteve

të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë. Këtë Projektligj e ka prezantuar ministri i Ekonomisë dhe Ambientit,

Blerim Kuçi i cili ka theksuar se është pjesë e programit qeverisës dhe në përputhje të plotë me direktivat e BE-së. Kuçi duke iu përgjigjur anëtarëve të

këtij komisioni, theksoi se janë hapur procedurat për zgjedhjen e dy anëtarëve të bordit të ARKEP-it për të bërë funksional këtë bord.





# Oda e Afarizmit: Udhëzimi i ri për regjistrimin e makinave, i dëmshëm për qytetarët dhe bizneset

Oda e Afarizmit të Kosovës ka shprehur shqetësimin lidhur me hyrjen në fuqi të Udhëzimit për Regjistrimin e Veturave. Kjo odë ka kërkuar nga Banka Qendrore e Kosovës që ky udhëzim të kthehet në gjendjen e mëparshme në mënyrë që të merren parasysh edhe kërkesat dhe shqetësimet e komunitetit të biznesit. Sipas udhëzimit të ri, bizneset obligohen që të paguajnë 10 ditë para skadimit të sigurimit të regjistrimit të automjetit të vitit paraprak për vitin e ardhshëm, në mënyrë që të fitojnë një shkallë bonus në rastet kur nuk ka aksident ose dëm të deklaruar



**EPOKA  
ERE** Albulena S. MAVRAJ

**PRISHTINË, 17 NËNTOR-** Oda e Afarizmit të Kosovës (OAK) ka shprehur shqetësimin lidhur me hyrjen në fuqi të Udhëzimit për Regjistrimin e Veturave, ku sipas tyre është tejet i dëmshëm për bizneset, ku pagesa e regjistrimit të veturës shkon deri në 100 për qind të vlerës fillestare.

OAK-u ka vlerësuar se është duke pranuar në vazhdimësi ankesa nga bizneset lidhur me udhëzimin e ri mbi zbatimin e sistemit bonus-malus për

persona juridikë dhe persona fizikë të miratuar nga Banka Qendrore e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më 1 nëntor. “Oda kërkon nga Banka Qendrore e Kosovës që ky udhëzim të kthehet në gjendjen e mëparshme në mënyrë që të merren parasysh edhe kërkesat dhe shqetësimet e komunitetit të biznesit. Sipas udhëzimit të ri, bizneset obligohen që të paguajnë dhjetë ditë para skadimit të sigurimit të regjistrimit të automjetit të vitit paraprak për vitin e ardhshëm në mënyrë që të fitojnë një

shkallë bonus në rastet kur nuk ka aksident ose dëm të deklaruar. Kurse në rastet kur automjeti nuk regjistrohet nga 1 deri në 15 ditë nga dita e skadimit të regjistrimit atëherë nuk do të ketë bonuse. Kështu që shkalla bonus-malus do të mbetet e njëjtë edhe pse për atë automjet nuk ka dëme të deklaruar apo i njëjti nuk ka pasur aksidente. Ndërsa në rast të vonesës në vazhdim të sigurimit në afat prej 15 ditë, automjetet të cilat janë të regjistruara në emër të bizneseve direkt zhvendosen në

shkallën bazë”, thuhet në reagimin e OAK-ut.

Sipas OAK-ut, udhëzimi i miratuar nga Banka Qendrore e Kosovës ka hyrë në fuqi pikërisht në kohën kur situata financiare e qytetarëve dhe vetbizneseve është shumë e vështirë si pasojë e pandemisë Covid-19. “Ky udhëzim i miratuar nga Banka Qendrore, i dëmton edhe qytetarët që çdo ditë e më shumë po përballen me varfëri ekstreme. Sipas udhëzimit i cili ka qenë në fuqi deri më 1 nëntor të këtij viti në qoftë se sigurimi është

ndërprerë pas kalimit të periudhës së vëzhgimit në të cilën nuk është deklaruar dëm automjetet e bizneseve kanë pasur të drejtë për një shkallë premie më të ulët në rast se ndërprerja nuk ka zgjatur më tepër se tre vite. Udhëzimi i miratuar nga BQK-ja ka ardhur pa asnjë konsultim paraprak me palët e interesit ku me këtë rast palët e afektuara drejtpërsëdrejti nga ky vendim nuk kanë qenë të njoftuara dhe janë dëmtuar si pasojë e mungesës së informacionit”, është theksuar në reagimin e OAK-ut.

## Reçica me bashkëpunimin konkret me FMN-në për reformat sociale

**PRISHTINË, 17 NËNTOR (ER)-** Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, në kuadër të diskutimit për negociimin e programit për mbështetje financiare, me misionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar, ka realizuar një takim virtual me ekipin e këtij misioni, i përfaqësuar nga shefi i misionit për Kosovë, Gabriel Di Bella.

Në këtë takim, ministri Reçica bisedoi lidhur me gjendjen e pandemisë në Kosovë dhe sfidat të cilat po ballafaqohet Qeveria, përkatësisht Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, lidhur me efektin e pandemisë në mirëqenien sociale të qytetarëve të Kosovës.

Ministri Reçica para anëtarëve të FMN-së prezantoi politikën e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, konkretisht Reformat në fushën sociale të cilat janë duke u ndërmarrë

nga Ministria.

Gjithashtu, paraqiti propozim-planin dinamik, rreth Reformës Pensionale, Reformës së Asistencës Sociale, Reformën e Marrëdhënies së Punës dhe Pushimit të Lehonisë, etj.

Me këtë rast, ministri Reçica ka theksuar se Reforma Pensionale, Asistencës Sociale dhe Marrëdhënies së Punës janë shumë të rëndësishme për shtetin dhe qytetarët e saj, sepse drejtpërdrejt ndikojnë në mirëqenien e tyre, eliminojnë padrejtësitë, eliminojnë shumëfishësinë e ligjeve dhe krijojnë sistem të qëndrueshëm socio-ekonomik për vendin.

Ministri Reçica u pajtua me ekipin e misionit që të bashkëpunojnë ngushtë me qëllim që të gjinden zgjidhjet më të mira lidhur me këto reforma dhe që këto reforma të jenë në të mirë të qytetarëve dhe të qëndrueshme financiarisht.



## Ladrovci nënshkruan memorandum mirëkuptimi me organizatën rinore 'AKTI'

DRENAS, 17 NËNTOR (ER)- Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, të martën ka pritur në takim drejtorin ekzekutiv të OJQ "AKTI", Rexhep Gojnovci, me të cilin ka nënshkruar memorandumimin e mirëkuptimit për realizimin e projektit "përfshirja sociale dhe fuqizimi ekonomik i të rinjve dhe familjeve, përmes masave për krijimin e të ardhurave". Ky projekt implementohet me një fond librash prej 364 tituj të ndryshëm, gjegjësisht 800 ekzemplarë të rinj.

Development (BMZ) dhe Hermann-Gmeiner Fund Germany (HGFD). Me këtë rast kryetari Lladrovci ka falënderuar drejtorin Gojnovci dhe ka mirëpritur realizimin e këtij projekti në Komunën e Drenasit i cili do t'i përfshijë grupet e marginalizuara, kryesisht të rinjtë. Qëllimi i këtij projekti është që të kontribuojë drejtë përmirësimit të perspektivave të punësimit, mirëqenies sociale dhe ekonomike të të rinjve dhe familjeve në Komunën e Drenasit përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës.



## Biblioteka e qytetit të Mitrovicës pasurohet me 800 ekzemplarë të rinj

MITROVICË, 17 NËNTOR (ER)- Biblioteka "Latif Berisha" në Mitrovicë është pasuruar me një fond librash prej 364 tituj të ndryshëm, gjegjësisht 800 ekzemplarë të rinj.

Me rastin e pranimit të librave, drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport, Tafil Peci është shprehur i kënaqur me këtë investim nga drejtoria të cilin e udhëheq ai, pasi që në këtë mënyrë pasurohet biblioteka me vepra tjera letrare, si dhe kontribuojmë në rritjen e fondit të librave.

Gjithashtu ai ka bërë me dije se ky investim është realizuar me qëllim që lexuesit e qytetit tonë të kenë shumëllojshmëri të veprave, në të cilat ata mund të gjejnë vetën e tyre, andaj u uron të gjithë adhuruesve të librit për këtë pasuri letrare,




dhe nga thellësia e zezës ju dëshiron lexim të këndshëm. Vlen të potencohet se këta libra janë blerë nga planifikimi buxhetor i Drejtorisë për

Kulturë, Rini dhe Sport në vlerë prej 10 mijë euro, dhe do t'ju shërbejnë lexuesve dhe shfrytëzuesve të Bibliotekës së qytetit.

## Përurohet një nënkalim në Ferizaj

FERIZAJ, 17 NËNTOR (ER)- Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka bërë me dije se kanë përfunduar punimet në nënkalimin në Nikadin-Varosh. Ai ka thënë se ky nënkalim është ndërtuar sipas standardeve moderne infrastrukturore. "Përfunduan

detajet e punimeve, sinjalistika, ndriçimi publik e gjelbërimi në veprën e re moderne të infrastrukturës rrugore tek nënkalimi për vetura e këmbësorë në Nikadin-Varosh, qarkullimi përmes së cilës do të nis nga e mërkura", është shprehur Aliu.



## Nënshkruhet marrëveshja për menaxhimin e sistemit të ujësjellësit në lagjen 'Çamëria'

KAMENICË, 17 NËNTOR (ER)- Nënkryetari i Komunës së Kamenicës, Faton Jakupi së bashku me drejtorin e Drejtorisë për Shërbime Publike, Ambient dhe Inspektorat, Zotrim Kastrati dhe udhëheqësin e Sektorit për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Ambientit, Hysen Jerliu kanë pritur në takim kryeshefin ekzekutiv të KRU "Hidromorava", Muhamed Suliqi, drejtorin teknik, Mumin Morina si dhe drejtorin e "Hidromoravës" njësisia në Kamenicë, Sherif Thaçi. Gjatë takimit nënkryetari Jakupi ka nënshkruar marrëveshje me kryeshefin ekzekutiv të KRU "Hidromorava", Muhamed Suliqi, mbi sanimin dhe

mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit në lagjen "Çamëria". Nënkryetari Jakupi ka thënë se përmes kësaj marrëveshje ujësjellësi në lagjen "Çamëria" do të mirëmbahet nga KRU "Hidromorava" në Gjilan. "Qëllimi i kësaj Marrëveshje është sanimi dhe vënia nën menaxhim dhe mirëmbajtje të KRU "Hidromorava" Gjilan, për shërbimet e ujit në sistemin e rrjetit të ujësjellësit për banorët e lagjes 'Çamëria' në mënyrë që ata të kenë ujë të përdorshëm", ka thënë ai. Ndërsa kryeshefi ekzekutiv i KRU "Hidromorava", Muhamed Suliqi, dhe drejtori i Hidromoravës, njësisia në Kamenicë, Sherif Thaçi, kanë thënë se do të angazhohen për sanimin dhe rregullimin e puseve të ujit për furnizim.



# MES MOSPËRFILLJES, KUSHTËZIMEVE DHE INJORANCËS (1)



**Shkruan: Agron HOTI**

Shtetet e vogla, sidomos ato nëpër rajone historikisht jostabile, armiqësore dhe të varfra siç p.sh. ka qenë Ballkani në së paku 150 vitet e fundit, e kanë të vështirë të realizojnë shpejtë dhe në masë të madhe objektivat e tyre politike dhe ekonomike.

Sepse përpos varësisë nga e kaluara së rëndë si pengesë serioze për zhvillime nacionale dhe integritet rajonale, shtete të tilla kanë dhe kapacitete të kufizuara në shumë dimensione të mundshme. Gjithsesi që pozita gjeografike e një shteti të vogël ka shumë rëndësi për fuqinë e mëdha sa i përket integritet ekonomik, transportit, shpërndarjes së energjisë dhe para se gjithash sigurisë fizike.

Një shtet i vogël në vendin e "duhur" në glob mund të bëhet shumë i rëndësishëm për fuqinë e mëdha. Islanda, është rast tipik. Edhe pse me përjashtim të Gardës Detare nuk ka forca të armatosura, vendndodhja strategjike e bën këtë shtet pikë të rëndësishme për sigurinë e transatlantike. Për këtë arsye Islanda hyn në grupin e 12 shteteve themeluese të NATO-s. Ose ta marrim p.sh. Korenë Jugore, Tajvanin dhe Japoninë që gjenden në pikën me nevrjalgjike në glob për interesat e ShBA-së në Azi Lindore. Kjo sepse pranë tyre kalon mbi 2/3 e tregtisë globale, ndaj edhe janë jetike për sigurinë e rrugëve detare për ShBA-në në Pacifik dhe jo rastësisht mbështeten fuqishëm nga ShBA. Ka plot njerëz në Kosovë që mendojnë se edhe vendi ynë i vogël është i rëndësishëm jetike për ShBA-në. Sigurisht që ShBA, ka qenë mbështetësi kryesor i shtetbërjes dhe shtetkonsolidimit të Kosovës, sepse mu kjo mbështetje e ka futur Kosovën dhe shqiptarët nën ombrellën e perëndimit për herë të parë qysh prej sundimit të Perandorisë Romake. Krahas kësaj, futja në NATO dhe BE e Bullgarisë, Rumanisë, Hungarisë, Greqisë, Sllovenisë e Kroacisë si dhe futja në NATO e Malit të Zi, Shqipërisë e Maqedonisë së Veriut përpos që i ka zvogëluar në minimum gjasat e ndonjë invazioni rus në Ballkan, siç kishte ndodhur diku apo gati-ndodhur diku tjetër gjatë periudhës komuniste, ka orientuar Ballkanin (përfshirë Serbinë) kah perëndimi, i cili (një pjesë e mirë e tij) jo shumë larg

nga sot ishte tërësisht nën ombrellën e interesave lindore të Perandorisë Sovjetike, dhe më herët në Perandorinë Osmane dhe Bizantine. Dhe duke parë që rrëshqitja e Kosovës kah Rusia është praktikisht e pamundur sot jo vetëm për shkak të "gardhit" të NATO-s përreth Kosovës, por edhe orientimit tërësisht properëndimor të Kosovës, atëherë edhe fokusi i ShBA-së ndaj Kosovës ka nevojë për më pak energji se sa që kërkohet p.sh. në Japoni, Tajvan, Kore Jugore apo Islandë, pavarësisht faktit që ShBA vazhdon të jetë mbështetësi kryesor në botë i pavarësisë dhe shtetësisë së Kosovës. Vetë prezenca e vogël ushtarake amerikane në Kosovë, krahasuar me prezencë të fuqishme ushtarake në Gjermani, Itali, Turqi, Japoni, Norvegji, Kore Jugore, Lindje të Mesme, në Golf, etj. tregon për peshën aktuale të Kosovës për ShBA-të karshi vendeve të lartpërmendura. Pra, me një fjalë, është perëndimi i kryesuar nga ShBA ai që bëri të pamundurën që Kosova të vazhdojë të ecën në këmbë të veta. Sigurisht që në këtë rrugë perëndimi ishte vazhdon të jetë i sfiduar dhe penguar në vazhdimësi nga Rusia, Kina me aleatë të tyre. Kurse në Kosovë është krijuar një bindje e segmenteve të caktuara politike e ushqyer nga qarqe të ndryshme të brendshme dhe të jashtme për interesa të pastra kalkulative politike, se politika e Kosovës ka qenë fajtorja kryesore për ngecjen ekonomike të Kosovës që nga paslufta e deri më sot. Largimi i fuqisë së re punëtore nga Kosova i atribuohet ekskluzivisht kësaj politike, dikujt më shumë e dikujt më pak. Sigurisht që përgjegjësia politike si në çdo vend të botës edhe në Kosovë është e pashmangshme edhe përkundër pushtetit të paktë që kishte Kosova gjatë kohës së UNMIK-ut, por moszhvillimi ekonomik i Kosovës nuk mund t'i atribuohet ekskluzivisht politikës tonë, sepse fundja shqiptarët me shekuj derdhen gjak për ditë më të mira, me shekuj ishin të pushtuar dhe nuk u lejuan të zhvilloheshin në asnjë dimension të mundshëm kombëtar dhe kjo pati pasoja të paparashikuara që po na ndjekin edhe sot. Prandaj, dioptria kritike duhet shtrirë gjithmonë më gjerë, sepse zhvillimi ekonomik përpos trajektore historike të një vendi, varet tepër shumë edhe nga konstelacionet ekonomike dhe politike në rajon dhe më gjerë. E Ballkani nuk ka pasur dhe nuk ka një motor të zhvillimit ekonomik siç e ka BE Gjermaninë, e cila u jep shtysë të gjitha ekonomive të BE-së. Zhvillimet rajonale shkojnë paralelisht në çdo shtet të rajonit, nuk mund të jetë një shtet

shumë më i zhvilluar se të tjerët. Fqinjët e Gjermanisë nuk kanë shumë dallime në mirëqenie ekonomike e sociale karshi saj. Kjo vërehet shumë lehtë të rritjet ekonomike të rajonit, të cilat janë pak a shumë të ngjashme. Edhe po të zhvendosnim Zvicrën në mes të Ballkanit, do ta kishte të pamundur të ecte me ritmet ekonomike që i ka, sepse vetë ngathtësia e rajonit, e kaluara e rëndë historike, vështirësitë, jostabiliteti dhe fqinjësia e varfër e vendeve përreth do ta ngadalësonte dukshëm perspektivën ekonomike të saj. Fundja nuk mbeti Ballkani më i varfëri në Evropë që së paku 150 vite për shkak të paafësisë së politikave të këtyre vendeve, por për shkaqe krejtësisht tjera që botërisht dihen. Harrohet fakti që kryeqytetet e Ballkanit, për dallim prej të gjitha atyre të BE-së, edhe sot vazhdojnë të jenë të palidhura me rrugë moderne (autostrada e hekurudha), harrohet fakti që edhe brenda për brenda vetë shteteve të Ballkanit një pjesë e madhe e qyteteve apo rajoneve kryesore nuk janë të lidhura as sot me autostrada (ose së paku me rrugë moderne) dhe hekurudha, dhe kjo flet shumë për gjendjen e rajonit, diçka që sot si BE ashtu edhe ShBA, edhe pse me shumë vonesë, janë të interesuara ta ndryshojnë. Krijuesit e bindjes së përgjithshme se "tërë fajet për moszhvillim të mjaftueshëm ekonomik i ka politika e Kosovës" fare nuk duan t'ia dinë se Kosova dhe të gjitha hapësirat shqiptare ishin pjesa më e varfër, më e pashkolluar dhe më e terrorizuar në Evropë nga pushteti jugosllav. Derisa popujt evropianë pas Luftës së Dytë Botërore po konsolidonin radhët e veta dhe po pozicionoheshin në "fshatin" prosperues global, shqiptarët në Jugosllavi deri në vitin 1999 po përballeshin me politika shfarosëse, eksploatim dhe varfëri afrikane. Ka një pjesë të theksuar kosovare që për fat që keq edhe sot nuk e pranon që Kosova dhe të gjitha hapësirat shqiptare në Jugosllavi, përpos që qenë terrorizuar, qenë eksploatuar në kuptimin e plotë të fjalës, pra e tërë politika jugosllave qëllimshëm ishte eksploatuese në Kosovë dhe tërë hapësirat shqiptare. Kjo nuk do shumë koment kur shqiptarët përbënin numrin më të madh të të burgosurve politikë, të të përndjekurve, të të vrarëve dhe të të zhdukurve nga pushteti jugosllav. Si ka mundësi të zhvillohet një popull në rrethana të tilla kur shfarosja dhe lufta për ekzistencë shkonin dhemb për dhemb?! Fundja, eksploatimi i një populli dhe terrorizimi i tij shkojnë paralel, së paku historia konfirmon këtë. E kush më

shumë se shqiptarët e di këtë fakt? Shumëkush i ka harruar këto, shtetet se nuk i di ose i ka pritjet në shpërputhje me mundësitë. Shumëkush shtetet se nuk e di që Kosova prej vitit 1999-2008 nuk ishte shtet dhe kjo e thotë të tërën, për ata që duan ta kuptojnë. E për t'u bërë shtet Kosovës iu deshën mbi 100 vjet. Kaq e 'shkurtër' ishte kjo periudhë. Edhe atë ekonomi që e kishte Kosova që nga viti 1989 e deri në vitin 1999 ishte praktikisht e vdekur, gjersa prej vitit 1945 deri në vitin 1990 ekonomia dhe resurset e Kosovës po eksploatoheshin nga Jugosllavia në mënyrë më të pamëshirshme të mundshme. Për 10 vite (1989-1999) përpos amortizimit të industrisë dhe paralizimit të ekonomisë, Kosova humbi më të dhimbshmen dhe më të nevojshmen, pra humbi tregjet në rajon dhe më gjerë, ashtu siç humbën tregjet pothuaj të gjitha vendet komuniste. Vetëm se, asnjë prej vendeve komuniste nuk ishte as për së afërmi më keq se sa që ishte Kosova me hapësirat tjera shqiptare të ish-Jugosllavisë gjatë periudhës komuniste. E lufta për tregje ekziston prej se ekziston njerëzimi, po e humbe tregun vështirë se mund ta kthesh përsëri, së paku jo në plan afatshkurtër e afatmesëm, nëse kurrë më, diçka që Kosova është duke e përjetuar në kurrizin e saj. Shihni garën e tmerrshme globale për tregje dhe bëni krahasime. Që nga viti 1999 deri në vitin 2008 ekonomia e Kosovës, përfshirë privatizimin e dështuar dhe korruptuar, është drejtuar 100 për qind nga UNMIK-u. Shqiptarët edhe pse ishin pjesë e institucioneve të UNMIK-ut, ishin vetëm spektatorë të pafuqishëm për të mund ngritur zërin kur, ku dhe si duhej. Ç'është e vërteta spektri politik i Kosovës aq shumë ishte i kushtëzuar për të parë kah pavarësia dhe aq shumë ishte i mbërthyer ga politikat ditore, sa që nuk e kishte kapacitetin për të projektuar të ardhmen ekonomike të vendit. E UNMIK-u duke qenë indiferent nuk kishte ndonjë interes për zhvillimin e ekonomisë së Kosovës, diçka për të cilën spektri politik i Kosovës është dashur që së paku ta ngriste zërin ndaj degradimit dhe dekurajimit ekonomik që po ndodhte. E duke qenë se që nga viti 1999 dhe 2008 kërkohet një bashkëpunim dhe bashkëkoordinim i ngushtë me bashkësinë ndërkombëtare, veçanërisht me ShBA e BE, për të përgatitur terrenin e vështirë për pavarësinë e Kosovës, atëherë e tërë energjia politike vendore shkonte në atë drejtim, ndërkohë që qeverisja e mirë dhe zhvillimi ekonomik nuk kishin mundësi

edhe pse do të ishte ideale, të ishin temat qendrore karshi shtetbërjes që pritej me padurim nga qytetarët e Kosovës. Kush e mendon se tërë ky mega-organizim mes Kosovës dhe bashkësisë ndërkombëtare gjatë dhe pas luftës ka qenë asgjë, atëherë ai apo ajo nuk jeton në planetin tonë. Aq shumë energji ka shkuar për shtetbërje dhe aq shumë e tillë shkon dhe sot për shtetkonsolidim të papërfunduar (shihni bisedimet me Serbi), sa dikush sot me shumë lehtësi as që do t'ia dijë duke mohuar çdo të arritur, sado me vështirësi të jetë arritur ajo. Dhe harrohet se, të rralla janë ato shtete në botë që kanë qenë në gjendje që në momentin kur janë bërë shtet të përmbyllin hartat e tyre njëherë e përgjithmonë. Shikoni hartat e Francës, Gjermanisë, Italisë, Polonisë, Anglisë, Japonisë, Ruisë, e qindra shteteve tjera në botë dhe krahasoni si dukeshin ato para 100 apo 200 vjet e si duken sot. Atij që i është dukur e lehtë shtetbërja e Kosovës, le të bëjë krahasime se pse nuk po bëhen shtet: Kurdët, populli më i madh në botë pa shtet, Katalonia që përbën afër 30 për qind të GDP-së së Spanjës, Baskia në Spanjë, Ujgurët dhe Tibeti në Kinë, Tatarët në Krime, Skocia në Britani të Madhe, Valonët e Flamanët në Belgjikë, e sa e sa popuj pafund në botë më të pasur apo më të varfër dhe pse jo shumë më të mëdhenj në numër se sa Kosova. Botërisht dihet se përmbyllja e hartave territoriale shteteve evropiane u ka marrë së paku 200 vite e ndoshta shumë më tepër. Ndërkohë, dikush sot po pret - edhe pse kjo do të ishte ideale që një Kosovë e vogël të ketë të rregulluara të gjitha problemet e shtetkonsolidimit (përfshirë përmbylljen e hartës territoriale me fqinjët historikisht ofanzivë dhe gllabërues) dhe veç për 12 vite shtet të bëhet si Zvicra, e kur Zvicrës vetë i janë dashur së paku 400 vite për të ardhur këtu ku është sot. E ata që kanë menduar se Kosova me të shpallur pavarësinë do t'i rregullojë të gjitha problemet, përfshirë ato territoriale, ai apo ajo ka jetuar jashtë realitetit objektiv. Pra, injorohet fakti që Kosova u bë shtet me njëqind vështirësi mes mospërfilljes së UNMIK-ut për zhvillim ekonomik dhe mirëqenie sociale, kushtëzimeve të forta për pavarësi e shtetësi të bashkësisë ndërkombëtare dhe injorancës së kohëpaskohshme të politikës tonë, përfshirë interesat e ndryshme shpesh partikulare mes forcave të ndryshme politike në Kosovë.

(VIJON)

## Kramp-Karrenbauer: Evropa ende ka nevojë për ShBA-në dhe NATO-n

**BERLIN, 17 NËNTOR**- Evropa nuk do të jetë në gjendje të garantojë sigurinë e saj në dekadat e ardhshme, pa ndihmën e Shteteve të Bashkuara dhe NATO-s, tha ministrja gjermane e Mbrojtjes, Annegret Kramp-Karrenbauer. Ajo hodhi poshtë idenë e presidentit francez, Emmanuel Macron, për një strategji të pavarur evropiane të mbrojtjes. “Do të duheshin dekada që Evropa të ndërtonte një fuqi ushtarake konvencionale dhe bërthamore për të kompensuar kontributin që

SHBA-ja dhe NATO-ja kanë për momentin në sigurinë e bllokut”, tha ministrja gjermane. Presidenti Macron tha për revistën franceze “Revue Grand Continent” se Evropa ka nevojë për një strategji të pavarur të mbrojtjes edhe nëse në ShBA-ja do të ketë një qeveri të re që mund të rezultojë me lidhje më miqësore me evropianët. “Shtetet e Bashkuara do të na respektojnë ne si aleatë vetëm nëse jemi serioz në lidhje me pozicionin tonë dhe nëse kemi sovranitetin tonë të mbrojtjes. “Ne duhet të

vazhdojmë të ndërtojmë autonominë tonë, ashtu si Shtetet e Bashkuara bëjnë për vete, dhe ashtu si Kina bën për vete”, tha ai. Presidenti amerikan, Donald Trump, disa herë ka kritikuar vendet anëtare të NATO-s për kontributin e ulët financiar ndaj aleancës në krahasim me ShBA-në. Bashkimi Evropian dhe ShBA-ja gjatë viteve të presidencës së Trumpit, kanë pasur një sërë mospajtimesh edhe për zonat e konfliktit në botë, ku janë të pranishme trupat e NATO-s.



## Shefi i NATO-s paralajmëron kundër tërheqjes së shpejtë nga Afganistani

**BRUKSEL, 17 NËNTOR**- Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg ka paralajmëruar se blloku ushtarak mund të paguante një çmim të lartë nëse largon shumë herët trupat nga Afganistani.

Mediet kanë raportuar se presidenti amerikan, Donald Trump, së shpejti do të tërheqë një numër të lartë të trupave amerikane nga vendi i shkatërruar nga lufta. “Tani, përballemi me një vendim të vështirë. Ne kemi qenë në Afganistan për gati 20 vjet dhe asnjë aleat i NATO-s nuk dëshiron të qëndrojë më gjatë sesa është e nevojshme. Por, në të njëjtën kohë nëse largohemi shumë shpejt ose në një mënyrë të pakoordinuar, çmimi mund të jetë shumë i lartë”,



ka thënë Stoltenberg në një deklaratë. Ai tha se Afganistani “treqikon të bëhet edhe një herë një platformë për terroristët ndërkombëtarë për të planifikuar dhe organizuar sulme në

vendlindjet tona”. “Dhe ISIS (Shteti Islamik) mund të rindërtojë në Afganistan kalifatin terrorist që humbi në Siri dhe Irak”, tha ai. Reagimi i Stoltenberg erdhi pasi raportet e medias thanë se

Pentagoni kishte marrë direktiva për t'u përgatitur për të rikthyer edhe 2.000 forca të tjera amerikane nga Afganistani dhe 500 nga Iraku, para se presidenti i zgjedhur, Joe Biden, të inaugurohet më 20 janar. Nëse ndodhë tërheqja, atëherë do të mbeteshin 2.500 trupa në secilin vend, më pak sesa, siç kanë thënë zyrtarët ushtarakë amerikanë, është e mjaftueshme për të siguruar stabilitetin. Pentagoni nuk i ka konfirmuar raportet në lidhje me tërheqjen. Sipas një marrëveshjeje të nënshkruar në muajin shkurt midis talibanëve dhe Shteteve të Bashkuara, forcat e huaja do të largohen nga Afganistani deri në maj të 2021-ës në këmbim të garancive të talibanëve që të

angazhohen për ndërprerjen e lidhjeve me Al-Kaidën dhe grupe të tjera militante ndërkombëtare. Talibanët thanë në një deklaratë më 10 nëntor se mbeten të përkushtuar në zbatimin e marrëveshjes, pavarësisht nga mungesa e progresit në negociatat e paqes brenda-afgane në Katar. NATO-ja mori përsipër përpjekjen ndërkombëtare të sigurisë në Afganistan më 2003. Më 2014, ajo filloi të trajnonte dhe këshillonte forcat afgane të sigurisë, por gradualisht ka tërhequr trupat në përputhje me një marrëveshje paqësore të ndërmjetësuar nga ShBA. NATO mbështetet shumë në forcat e armatosura të ShBA-së në misionin e saj në Afganistan.

## Sulm vetëvrasës në një restorant në Somali

**MOGADISHU, 17 NËNTOR**- Pesë njerëz, dy nga të cilët policë, u vranë dhe më shumë se 19 të tjerë u plagosën të martën kur një sulmues vetëvrasës sulmoi një restorant në kryeqytetin somalez, Mogadishu, ka bërë të ditur policia.

Një zyrtar policor dhe dëshmitarët thanë se sulmuesi hyri në restorant dhe u drejtua afër akademisë së policisë dhe e hodhi vetën në ajër. “Të

plagosurit janë dërguar në spitalin më të afërt, por disa prej tyre kanë plagë serioze”, i ka thënë Mohamer Abdirahman, polic në vend të ngjarjes, agjencisë së lajmeve, AFP. Dëshmitari Abdulkadir Hussein tha se në kohën e shpërthimit, në restorant ishin dhjetëra persona. “Shumë nga këta njerëz u plagosën. Personalisht pash tmerrin me sy, pasi trupat e pajetë të dy personave ishin afër

meje. Shpërthimi shkatërroi gjithçka”, tha ai.

Deri më tash, askush nuk e ka marr përsipër përgjegjësinë për sulmin.

Grupi terrorist Al-Shabaab që është i lidhur me Al-Kaidën, ka sulmuar shpesh caqe civile dhe të qeverisë në Mogadishu, të cilin edhe e kontrollonte deri në vitin 2011, kur u dëbuan nga trupat ushtarake të Unionit Afrikan.



## Vaksina kundër Covid-19 në Belgjikë do të jetë falas dhe e padetyrueshme



**BRUKSEL, 17 NËNTOR**- Vaksina potenciale e zhvilluar kundër Covid-19 në Belgjikë do të jetë falas për popullin dhe nuk do të jetë e detyrueshme.

Ministri i Shëndetësisë i Belgjikës, Frank Vandenbroucke dha deklaratën për mediet lokale në lidhje me vaksinat potenciale kundër pandemisë dhe strategjisë së vendit ndaj vaksinave.

Ai tërhoqi vëmendjen se vaksina e Covid-19 nuk do të jetë e detyrueshme, duke theksuar se vaksina në fjalë do të jetë falas për shtetasit dhe ata që jetojnë në Belgjikë. Vandenbroucke tha se kur do të jetë në dispozicion një vaksinë efektive dhe e sigurt synojnë vaksinimin e të paktë 70 për qind të popullsisë, do të thotë 8 milionë persona. Sipas tij, prioritet në vaksinim do të jenë

punonjësit shëndetësor dhe të moshuarit, duke shtuar se vendimi përfundimtar në lidhje me këtë do të merren sipas propozimeve shkencore. Ministri Shëndetësisë ka theksuar se disa kandidatë për vaksina janë premtuese, ndërsa shprehu parashikimin se pjesa e parë e kufizuar e vaksinave presin të vijnë në fillim të vitit të ardhshëm.

# TRUE STORY (histori e vërtetë)



**XHEVAT KRAJA  
MARKASHI**

Ngjarja: Çdo të Hënë, pas ndrimit të dytë në 1500 mbledhja e "Team Leaders" shefat të ndrimit!

Vendi: Stacioni 4 (stacioni

Jugor) Lakrishtës, Prishtinë

Koha: Dhjetor 1999

Pas përfundimit të Mbledhjes së "Team Leaders" ku mirrte pjesë aty edhe "Team Leader" e Stacionit të Graçanicës, pasi në atë kohë stacioni e Graçanicës ishte në nën-stacionin e stacionit 4 jugorë të Prishtinës. Pasi përfundoi Mbledhja dhe orari i punës së ndrrimit e dytë, Polici Amerikan (me origjinë Shqiptare) e pytë Policin Anglez të Stacionit të Graçanicës a je me makinë, sepse Prishtinën e kaploj bora atë ditë dhe kerkoj ta qojë deri në banesë në Lagjen Ulpiana.

Polici Anglez: Po të qoj unë!

Polici Amerikan: a je vet?

Polici Anglez: jo është edhe përkthysja duke pritur në makinë, nuk e ka ndier veten të sigurtë me hy brenda këtu sepse është serbe.

Polici Amerikan: aha ani

Duke hyrë në makinë, Polici Amerikan ulet mbrapa, se para ishte e ulur përkthysja serbe e stacionit të Graçanicës.

Përkthysja Serbe: Pershendetje unë jam Milena.

Polici Amerikan: Pershendetje Unë jam Xhoi.

Polici Anglez (shoferi): ok, në Ulpiana, ku banon?

Polici Amerikan: në Lagjen D3 afër rrethit.

Përkthysja Serbe: a banon në

Ulpian aa?

Polici Amerikan: Po!

Përkthysja serbe: ahh edhe unë kamë banuar në Ulpianë, por tani pas luftës na nxorrën shqiptarët e UÇK-ja prej banesës.

Gati që nuk qante, vazhdonte duke treguar se çfarë terrori ka përjetuar prej shqiptarve pas luftës.

Polici Amerikan: Po me siguri edhe banesa juaj ishte e shqiptarit para vitit 1989!

Por dëgjo këtu ti, ne dhe krejt bota e dijmë kush kë e ka terrorizuar këtu, e kënd kush e ka nxjerrë prej banesave, e prandaj jemi ne këtu tani!!

Përkthysja serbe mbeti pa tekst

nga sikleti dhe vazhduam rrugën për 10 minuta pa fol më.

KONKLUZIONI: për 10 minuta rrugë përkthyesja serbe u perpoq ta viktamizojë vetin dhe njëllasë shqiptarët me propagandë.

Pyetje: Zoti e dinë, se sa ka mund ta bindë Policin Anglez, që është tanë ditën me të e për ditë.

Që me mua vetëm për 10 minuta që ka pasur takim u perpoq të më bind se kush është viktima e kush ishte krimineli në Kosovë?!

*XHEVAT KRAJA MARKASHI  
Ish- Komandanti i Stacionit nr  
4 të Lakrishtës në Prishtinë,  
prej Korrik 1999 deri në Shtator  
2000.*





# Simboli me kuptim... sekret!?

Si u bë brumë i teorive të konspiracionit, syri brenda një trekëndëshi. Matthew Wilson e analizon historinë e këtij simboli. Pjesë të shkrimit të tij të publikuar në BBC Culture

Teoritë e konspiracionit vlojnë nga simbolet e koduara dhe shenjat e kamufluara. “Syri i Providencës” – një sy i vendosur brenda një trekëndëshi – është simbol i tillë, i lidhur me masonerinë, por që gjithashtu ndërlidhet me iluminatët apokrifë – një grup sekret i individëve elitarë që pretendohet se duan t’i kontrollojnë çështjet globale.

Syri i Providencës është nxitje për teoricienët e konspiracionit, sepse është shumë i pranishëm; ai jo veç që shfaqet në kishat e shumta dhe ndërtesat masonike në gjithë botën, por gjithashtu edhe në pjesën e prapme të kartëmonedhës amerikane prej një dollari si dhe në stemën e Shteteve të Bashkuara.

Në fakt, duket zgjedhje e pazakontë dhe e çuditshme për të qenë simbol i shtetit amerikan. Syri i patrupëzuar përçon sensin e një Vëllai të Madh autoritar. Në kombinim me piramidën poshtë, na del një emblemë që sugjeron një kult antik dhe ezoterik.

Por, cilat janë origjinat e “Syrit të Providencës”? Pse na magjeps kaq shumë dhe pse lidhet shpesh me masonët dhe iluminatët?

Fillimisht, Syri i Providencës ishte simbol i krishterë dhe shembujt më të hershëm të përdorimit të tij mund të gjenden në artin fetar të periudhës së Rilindjes, për ta

përfaqësuar Zotin. Një shembull i hershëm është “Darka e Emausit”, piktura e Pontormos e vitit 1525, edhe pse vetë simboli u pikturoa më vonë – mbase në vitet 1600. Një burim tjetër me rëndësi, i kësaj ikone, është një libër emblemash i quajtur “Ikonologjia”, i botuar së pari më 1593. Në botimet e mëvonshme, Syri i Providencës u përfshi si një atribut i personifikimit të “Providencës hyjnore” d.m.th. të dashamirësisë së Zotit. Siç sugjeron emri i simbolit dhe përdorimi i tij i hershëm, u shpik si një shenjë e vigjilencës së dhembshur të Zotit ndaj njerëzimit.

Askush nuk është i sigurt se kush e

shpiku fillimisht, por kushdo që e bëri, e modeloi nga një sërë motivesh fetare që ekzistonin që më parë. Trekëndëshi ishte simbol i kahershëm i Trinisë së Krishterë të Atit, të Birit dhe të Shpirtit të Shenjtë; ndonjëherë, në shekujt e mëparshëm, Zoti madje përshkruhej me një aureolë trekëndore. Rrezet e dritës që shfaqen shpesh, që burojnë nga simboli, janë gjithashtu një shenjë para-ekzistuese e shkëlqimit të Zotit në ikonografinë e krishterë.

Por, cilat janë zanafillat e atij syri të frikshëm pa trup?


Zoti është përshkruar në mënyra të shumta të fshehta më parë, të tilla si një dorë e vetme që dilte nga një re, por jo si një sy. Është e drejtë të thuash se një sy i izoluar ka ndikim psikologjik, duke treguar autoritet edhe për shikuesin e duke nënkuptuar një vigjilencë. Ju madje mund ta shihni këtë efekt në natyrë, me



Në kartëmonedhën prej një dollari amerikan, Syri i Providencës është mbi piramidën prej 13 kateve që simbolizojnë shtetet themeltare



Simboli i burgut “Panoptikon” që synonte që të burgosurit të mos e dinë kurrë se kur vëzhgohen



Dizajni që William Barton bëri për Stemën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës u përdor në anën e pasme dhe me moto ndryshe

disa kafshë që kanë zhvilluar “sy” në lëkurën e tyre për të trembur grabitqarët. Fotografii surrealist, Man Ray, e përmbodhi më së miri misterin e syrit pa trup kur tha se “Pasqyra e rreme” e punuar nga René Magritte më 1929, “shikon



Stema amerikane e përdorur më 1782

aq sa shihet vetë”.

Por, ka një histori më të thellë në syrin si simbol, që duhet marrë parasysh – një që na kthen përsëri në fetë më të vjetra. Në mijëvjeçarin e tretë p.e.s., sumerët e përçuan shenjtërinë e disa skulpturave duke zgjeruar në mënyrë jonormale sytë, për të rritur ndjesinë e vigjilencës së qëllimshme. Ata madje mbanin ceremoni në të cilat artistët sillnin skulpturat në jetë duke “hapur” sytë e figurave.

Por, egjiptianët e lashtë ishin krijuesit e syrit si motiv: për shembull, një palë sysh të pikturuar në një arkivol që lejonin të vdekurit të shihnin në jetën e përtejme. Dhe, një nga më të famshmit, nga të gjitha simbolet egjiptiane, mbetet Syri i Horusit. Ky motiv është në të vërtetë një hibrid i një syri njerëzor dhe skifteri. Sipas mitologjisë së lashtë egjiptiane, Horusit zot-mbret (shpesh i përshkruar si një fajkua ose me kokën e një fajkoi) i ishin prerë sytë në një betejë me xhaxhain e tij, Setin. Me ndihmën e Thothit, ai më vonë i shëroi sytë

e tij. Syri i Horus ishte pra simbol mbrojtës, shpesh i përdorur si një amulet – një skulpturë mjaft e vogël që një person e mbante në xhep si formë mbrojtjeje.

Ky dhe një hieroglifi tjetër egjiptian i syrit të izoluar njerëzor, vazhduan të ndikojnë në ikonografinë evropiane gjatë Rilindjes. Në atë kohë, studiuesit dhe artistët kishin një magjepsje me shkrimet egjiptiane; problemi i vetëm ishte se ata nuk e kuptuan plotësisht atë dhe përkthimet ishin të pasakta. Një nga më të famshmit u shfaq në një romancë të vitit 1499 të titulluar “Ëndrra e Polifilos”, ku përkthimi i simbolit egjiptian të syrit ishte “Zoti”.

Kjo buroi nga një keqkuptim thelbësor i përdorimit original të hieroglifëve. Në ditët e sotme e dimë se ato ishin gjuhë e shkruar, kryesisht me shenja fonetike, por në vitet 1400 dhe 1500 besohej se kishin një domethënie shumë më mistike. Simbolet, në shkrimet hieroglifike – kafshë, zogj dhe forma abstrakte – mendohej se ishin qëllimisht misterioze, secili duke krijuar kuptim përmes frymëzimit sesa si një pjesë e një sistemi gjuhësor. Ato ishin, siç besohej, enigma të hapura që përmbajnë kuptime të shumëfishta.

Ky besim pati efekt të madh në artin evropian. Kur dolën fjalorët e simboleve, si “Emblemata” e vitit 1531 nga Andrea Alciati dhe më vonë “Ikonologjia” nga Cesare Ripa, theksi u vu te simbolet vizuale kriptike, shpesh tepër komplekse, ku shikuesi futet si pjesëmarrës në deshifrim si dhe konstruktues i kuptimit. Si rezultat, një motiv si “Syri i Providencës” ishte qëllimisht ezoterik. Është simbol i ndërtuar pothuajse me qëllimin për t’u riinterpretuar, dhe ndoshta edhe për t’u keqinterpretuar. E, kjo me të vërtetë ndodhi në fund të shekullit të XVIII-të. Tre shembuj kryesorë nga kjo periudhë demonstronjë një diversitet të simbolikës së “Syrit të Providencës”.

Në Francën post-revolucionare, Deklarata e të Drejtave të Njeriut dhe Qytetarit, nga Jean-Jacques-François Le Barbierit (1789), e paraqiti tekstin me “Syrin e Providencës” në krye. Në këtë rast, ai është bërë instrument i arsyes paternaliste, për të vëzhguar kombin e ri egalitar.

Në Britani, më 1794, Jeremy Bentham e porositi arkitektin Willey Reveley që t’ia projektojë atij një logo për “Panoptikonin” e tij – burgun e ri revolucionar që synon të ketë mbikëqyrje të vazhdueshme të secilës qeli. Dizajni përfundimtar përfshinte Syrin e Providencës – një simbol i vështrimit të pandërprerë të drejtësisë gjyqësore – i rrethuar nga fjalët “Mëshirë”, “Drejtësi” dhe “Vigjilencë”.

Disa vjet më parë, më 1782, u zbulua Sema e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Thomas Jefferson, Benjamin Franklin dhe John Adams i kishin dhënë idetë e tyre për modelin, por ishte Charles Thomson, sekretari i Kongresit Kontinental, i cili doli me piramidën dhe Syrin e Providencës – ndër elementët tjerë të vulës (në bashkëpunim me një avokat dhe artist të ri me emrin William Barton). Piramida e papërfunduar kishte për qëllim të simbolizonte “forcën dhe qëndrueshmërinë”, me 13 nivele që përfaqësonin 13 shtetet



Syri hyjnor në “Darkën e Emausit” nga Pontormo (1525), është pikturuar më vonë për të fshehur një fytyrë të ndaluar nga kundër-reformimi



Syri i Horusit si hajmali mbrojtëse



Syri i Providencës në Deklaratën e të Drejtave të Njeriut dhe Qytetarit (1789)

themeltare të Amerikës. Syri i Providencës – si dy shembujt e tjerë nga e njëjta periudhë në Britani dhe në Francë – ishte simbol tradicional për mbikëqyrjen dashamirëse të Zotit për kombin e ri. Në asnjë prej këtyre shembujve, masoneria nuk u përfshi në përzgjedhjen e simbolit.

E çka për iluminatët? Detajet e viteve të para të grupit themeltar – të krijuar në Bavari më 1776 dhe të shpërbërë në 1787 – janë relativisht të paqarta. Ne

gjithashtu nuk e dimë se sa të rëndësishëm ishin simbolet vizuale për atë rendi. Është e vërtetë që iluminatët u frymëzuan nga idetë që qëndronin pas masonerisë, e cila e kishte përdorur në mënyrë sporadike Syrin e Providencës si simbol të Arkitektit Suprem (Zotit), duke ndjekur shembullin e shumë kishave të tjera në atë kohë.


Sidoqoftë, masonët nuk e përdorën shumë simbolin e Syrit të Providencës, deri të paktën në fund të shekullit XVIII, dhe jo para



Në Librin e Orëve, Zoti përshkruhet me aureolë trekëndore që i referohet trinisë së krishterë




Syri i magjepsit Surrealistët, si portë mes unit të brendshëm dhe botës së jashtme. Në këtë foto është “Pasqyra e rreme” nga Rene Magritte (1929)



Sumerët me sytë e stërmadhuar e shfaqnin shenjtërinë e figurave hyjnore

se Benthami, Le Barbieri, Thomsoni dhe Bartoni ta kishin miratuar atë për qëllimet e tyre. Për fat të keq të teoricienëve të konspiracionit, Syri i Providencës

në kartëmonedhën prej një dollari na flet më tepër për estetikën e fundshekullit XVIII sesa për autoritetin e elitave sekrete. /Telegrafi/



QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'  
TEL: 045/82 82 82

## Kosova kërkon fitore ndaj Moldavisë për të mbetur në Ligën C

“Dardanët” presin fitore sonte ndaj Moldavisë në “Fadil Vokrri”, në mënyrë që të mbesin në Ligën C dhe t’i rikthehen rezultateve pozitive. “Ka qenë vit i vështirë, por kemi fituar përvojë. E kemi ndeshjen e fundit ku synojmë të qëndrojmë në Ligën C”, ka thënë Muharrem Sahiti, ndihmëstrajner i Përfaqësues së Kosovës



**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 17 NËNTOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll sonte (e mërkurë) do të zhvillojë ndeshjen e fundit në Ligën e Kombeve kundër Moldavisë. Synim i “dardanëve” në këtë ndeshje është fitorja në mënyrë që të sigurohet mbetja në Ligën C. Kështu ka bërë me dije trajneri Muharrem Sahiti, i cili e drejton Kosovën në mungesë të Bernard Challandesit. “Ka qenë vit i vështirë, por kemi fituar përvojë.

E kemi ndeshjen e fundit ku synojmë të qëndrojmë në Ligën C. Do ta presim shortin në dhjetor, duhet të bëhemi gati për ciklin kualifikues. Mendoj se jemi penalizuar më së shumti, por tash gjendja e lojtarëve është e mirë. Paraqitja ndaj Sllovenisë na ka ngritur moralisht, ndaj Moldavisë jemi favorit. Por, kjo nuk duhet të jetë bazë por të përqendrohemi maksimalisht për ta synuar fitoren”, ka thënë Sahiti. “Nuk jemi të kënaqur me rezultatet dhe duhet të punojmë për t’u kthyer vetëbesimi dhe ne duhet ta kemi të qartë që nuk

jemi prej atyre më të fortëve, pasi çdo mungesë ka qenë e madhe për ne. Po besoj se shumë shpejtë dhe qysh nga e mërkura të organizohemi”, ka shtuar Sahiti. I pranishëm në konferencë para ndeshjes për ndeshjen me Moldavinë ishte edhe mesfushori Herolind Shala. Ai ka vlerësuar se Kosova është favorite në këtë ndeshje dhe se synon t’i rikthehet fitoreve. “Besoj që treguam kualitet dhe lojë të mirë me Slloveninë, por nuk kishim fat. Jemi favorit në shtëpinë tonë, e dimë se Moldavia mund të na shkaktojë

probleme por ne luajmë për fitore. Normalisht që nuk kemi arrit fitore që shumë ndeshje është problem, por kemi besim tek stafi teknik dhe tek njeri-tjetri andaj nesër duhet të dalim në

fushë si ekip dhe të rikthehemi tek rezultatet pozitive”, ka thënë Shala. Ndeshja në mes Kosovës dhe Moldavisë zhvillohet sonte (e mërkurë) nga ora 20:45 në stadium “Fadil Vokrri”.

## Challandesi sërish rezulton pozitiv me Covid-19. Ftohet Armend Thaqi



PRISHTINË, 17 NËNTOR - Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës, Bernard Challandes do t’i mungojë ekipit edhe në ndeshjen e nesërme kundër Moldavisë, pasi ka rezultuar pozitiv me Covid-19 edhe në testin e dytë. “Në rezultatet e sotme në testin për Covid-19 përzgjedhësi Challandes ka

dalë pozitiv. Kësisoj, ekipin përfaqësues në ndeshjen kundër moldavëve do ta drejtojë ndihmësi i parë, Muharrem Sahiti. Fatmirësisht, gjendja shëndetësore e përzgjedhësit Challandes është shumë e mirë dhe vazhdon të jetë pa simptoma”, thuhet në njoftimin e Federatës së

Futbollit të Kosovës. Ndërkohë, për ndeshjen kundër Moldavisë është ftuar në përfaqësues edhe mbrojtësi i Ballkanit, Armend Thaqi. Ai tashmë iu ka bashkuar ekipit dhe do të jetë në dispozicion të trajnerëve për stërvitjen e sotme dhe për ndeshjen që zhvillohet nesër në stadiumin “Fadil Vokrri” në orën 20:45.

## Shqipërisë i duhet fitorja ndaj Bjellorusisë për vendin e parë në grup

TIRANË, 17 NËNTOR - Kombëtarja e Shqipërisë në futboll sot (e mërkurë) e zhvillon ndeshjen vendimtare ndaj Bjellorusisë për vendin e parë në grup. Edy Reja, në konferencën për shtyp para ndeshjes përcaktuese për vendin e parë në grup, ka thënë e nuk do të bëjë ndryshime të mëdha në formacion krahasuar me atë të ndeshjes së fundit kundër Kazakistanit. “Duhet të jemi të qetë, të kemi siguri. Duhet të kemi besimin e njerëzve dhe stafit teknik. Të qëndrojmë të qetë. Presioni është pjesë e

futbollit. Kemi cilësitë e duhur për të bërë një ndeshje futbollit. Jam i bindur që do të bëjmë një ndeshje të mirë. Duhet të kemi ekuilibër përgjatë 90 minutave. E rëndësishme është që të mos humbim ekuilibrin. Bjellorusia është një skuadër që mblidhet mirë pas dhe ka kundërsulm të shpejtë. Duhet ta menaxhojmë ndeshjen sipas situatave të krijuara. Nëse ruajmë ekuilibrin do të bëjmë gjëra të mira”, ka thënë Reja, duke shtuar: “Kur caktohen datat, nuk mund të lëvizim. Kishim dëshirë të

luanim në një fushë tjetër, për shkak të terrenit, por nuk ishte e mundur. Di që është punuar për ta rikthyer fushën në një gjendje sa më optimale. Fusha do të jetë njësoj për të dyja skuadrat, kush është më i zoti do të fitojë”. Për ndeshjen ndaj Bjellorusisë ka folur edhe kapiteni i kombëtares kuqezi, Etrit Berisha. Ky i fundit ka thënë se Shqipëria ka cilësi për ta fituar ndeshjen. “Sfida me Kazakistanin ishte shumë e rëndësishme, ishte një hap i mbarë. Fillimi i mbarë, ishte gjysma e punës. Unë mendoj



që kualitetin e kemi, duhet të jemi të qetë. Kemi më shumë cilësi se ekipet e tjera. Duhet të futemi të qetë për të fituar

ndeshjen. Gjithë çunat janë të vetëdijshëm se duhet të japim maksimumin”, ka thënë Berisha.



## Hamilton: Thonin që zezakët nuk fitojnë, nuk ndalem këtu

LONDËR, 17 NËNTOR - Lewis Hamilton shkroi historinë e Formula 1, duke fituar titullin e 7-të kampion bote dhe barazuar rekordin e Michael Schumacher. Piloti me ngjyrë britanik shprehet se për të nuk ka qenë e lehtë të garonte në këtë

sport dhe arrinte deri këtu për shkak të ngjyrës së lëkurës së tij. "Kam luftuar gjithnjë edhe kundër paragjykeve, që kur isha fëmijë, pasi gjithnjë thonin se zezakët nuk mund të fitojnë. Kjo është arsyeja që unë jam shumë aktiv jashtë

pistës, në betejat për të drejtat humane, të barazisë dhe në mbështetje të njerëzve me ngjyrë", ka thënë Hamilton. "Kur kam qenë fëmijë ëndërroja të paktën të garoja, nuk e imagjinoja që do të arrija deri këtu. Gëzohesha kur

shihja Schumacher që fitonte një garë dhe të arrija deri në Formula 1 ishte objektivi im kryesor. Tani kam 7 tituj kampionë, i kam merituar, por nuk ndalem këtu. Kam mundësi për më shumë", ka shtuar Hamilton.



## Qeveria e Kosovës ndihmon 38 Federata Sportive me një vlerë totale prej 1.5 milion euro

PRISHTINË, 17 NËNTOR - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, qëndroi për një vizitë në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ku bashkë me ministren Vlora Dumoshi, ndanë marrëveshjet për mbështetje financiare për 38 të Federatave Sportive të Kosovës. Vlera e mjeteve financiare me marrëveshjet e nënshkruara nga ministrja Dumoshi dhe nga kryetarët e federatave përkatës vjen nga fondi për mbështetjen e sportit në kohë të pandemisë me një shumë totale prej mbi 1.5 milion euro, ku do të përfitojnë 627 klube, me rreth 26,000 sportistë.

Kryeministri Hoti, përgëzoi kryetarët e federatave, presidentin e Komitetit Olimpik të Kosovës, përfaqësuesit e federatave dhe sporteve të ndryshme për punën që po e bëjnë, në respektimin e masave kundër pandemisë. "Më vjen mirë që kemi arritur të ndajmë një pjesë të mbështetjes që ju të përballemi me këtë situatë të vështirë nëpër të cilën po kalojnë të gjithë qytetarët e vendit pa përjashtim", ka thënë kryeministri Hoti, dhe shtoi se edhe për vitin e



ardhshëm është paraparë një pako e mbështetjes që përfshinë edhe fushën e kulturës, rinisë dhe sportit. Ndërkaq, ministrja Dumoshi ka sqaruar se gjatë vitit 2020, Qeveria e Kosovës ka mbështetur me 3 milionë e 985 mijë euro për investime kapitale në përmirësimin e infrastrukturës sportive, kurse përmes subvencioneve të ndryshme përgjatë vitit 2020 klubet

sportive janë ndihmuar edhe me 2,586,540.20 euro. "Qeveria e Kosovës ka treguar përkushtim dhe vëmendje maksimale ndaj dikastereve të MKRS-së duke mbështetur financiarisht kulturën e sportin në përballjen kundër Covid-19 dhe duke pasur në vëmendje artistët e sportistët si kategori e prekur nga situata aktuale", ka deklaruar ministrja Dumoshi.

## Shtyhen dy xhirot e radhës të Superligës

PRISHTINË, 17 NËNTOR - Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK) ka vendosur që për shkak të dy ndeshjeve të Përfaqësueses së Kosovës në muajin nëntor në kuadër të Dritares së Dytë të parakualifikimeve evropiane për Kupën e Botës 2023, dy xhirot e radhës të Prince Caffe Superligës së Kosovës të shtyhen për më vonë. Basketbollistët e Kosovës dhe shtabi teknik në krye me përzgjedhësin Christos Marmarinos do të jenë së bashku në një hotel në Prishtinë, që nga dita e mërkurë dhe do të stërviten në Marigona Residencë. Ata nuk do të kenë kontakte me familjet e tyre dhe bashkëlojtarët në klubet ku



aktivizohen, pasi që Federata e Basketbollit të Kosovës nuk dëshiron që të rrezikojë që ndonjëri prej

anëtarëve të delegacionit të infektohet me Covid-19. Pra, shtyrja e dy xhirove është bërë për shkak që basketbollistët, të cilët janë pjesë e Përfaqësueses së Kosovës të karantinohen së bashku në mënyrë që të jenë të gatshëm në të gjitha aspektet për sfidat ndaj Sllovakisë dhe Islandës, që do të zhvillohen më 26 dhe 28 nëntor në Bratislavë. Basketbollistët e Kosovës të hënën janë testuar (PCR) në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike, derisa rezultatet do të dalin të martën. Po ashtu anëtarët e delegacionit të Kosovës do të testohen edhe një herë (më datë 21 nëntor) para se të udhëtojnë për në Bratislavë.

### SHKURT

#### Interi ofron Eriksenin për Xhakën

Christian Eriksen dhe Interi nuk janë "martesa" ideale dhe ndarja nuk është aspak larg. Mesfushori dhe Conte nuk kanë arritur ta kuptojnë njëri-tjetrin dhe danezi nuk ka arritur të rikthehet në nivelet kur luante në Premier Ligë të Tottenham Hotspur. Mediet italiane janë të sigurta se Eriksen do të largohet nga Interi, madje zbulojnë edhe lëvizjet për në merkaton e janarit. "Corriere dello Sport" raporton se Arsenal ka propozuar shkëmbimin e Eriksen me një shqiptar. Granit Xhaka mësohet t'i jetë ofruar Marottas e Contes në shkëmbim të yllit danez. Kapiteni i Zvicrës është një ide tunduese për Interin, pasi grinta dhe tiparet e tij mund t'i përshtaten lehtë skemës 3-5-2 të zikaltërve. Në janar pritet të ketë lëvizje më konkrete për këtë operacion.

#### Suarezi infektohet me Covid-19

Sulmuesi i Atletico Madridit, Luis Suarez ka rezultuar pozitiv në testin për Covid-19. Sulmuesi nga Uruguai pas marrjes së rezultatit është vetizoluar, derisa do të mungojë në ndeshjen kundër Barcelonës që pritet të zhvillohet më 21 nëntor.

#### Unitedi e dëshiron Sanchon

Manchester Unitedi ende është i interesuar për Jadon Sanchon, dhe "90min" raporton se klubi dëshiron një marrëveshje për lojtarin para Kampionatit Evropian që do të mbahet vitin e ardhshëm. Transferimi i Sanchos tek Unitedi është përfolur gjatë, ndërsa klubi pritet të arrijë marrëveshjen me Dortmundin në fillim të 2021-s. "Djajtë e Kuq" dështuan t'i afrohen çmimit të kërkuar nga Dortmundi në afatin e shkuar kalimtar. 20-vjeçari në 6 ndeshje këtë sezon në Bundesligë ka asistuar tre herë.

#### Tre lojtarë të Galatasarayt pozitivë me Covid-19

Tre lojtarë të tjerë të klubit turk të futbollit Galatasaray kanë rezultuar pozitivë me Covid-19, duke rritur numrin e përgjithshëm të rasteve në këtë klub në pesë. Lojtarët e infektuar janë izoluar, ndërsa ka filluar procesi i tyre i trajtimit, ka njoftuar klubi i Stambollit. Emrat e lojtarëve të infektuar nuk u zbuluan.

## Harden refuzon kontratën që do ta bënte më të paguarin, kërkon largimin

Basketbollisti James Harden kërkon të largohet nga skuadra teksane e Houston Rockets dhe këtë gjë ia ka bërë të qartë klubit. Ai ka refuzuar rinovimin

me skuadrën e Houstonit, që i kishte ofruar një kontratë të majme: 103 milionë dollarë për dy vite. Pra, James Harden ka refuzuar më shumë se 50

milione dollarë në sezon për dy vitet në vijim. Nëse pranonte këtë ofertë, ai do të bëhej basketbollisti i parë në historinë e NBA-së që do të fitonte kaq

shumë në një sezon. "Mjekra" mendon se nuk ka asnjë shans të tojë titullin të Houston, ndaj ka shprehur dëshirën për t'u larguar dhe synon të shkojë te

skuadra e Brooklyn Nets. Lojtari synon të bashkohet sërisht me Kevin Durant, por Houston kërkon shumë para për këtë transferim.



**CONTRACT NOTICE  
SERVICES**

According to Article 40 of Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092

Date of the preparation of the Notice: 20/11/2020

Procurement No	Assessment	001	2020	221
----------------	------------	-----	------	-----

This notice has been prepared in the LANGUAGES:

English

**SECTION I: CONTRACTING AUTHORITY**

**I.1) NAME AND ADDRESS OF THE CONTRACTING AUTHORITY (CA)**

Official name: Kosovo Humanitarian Charitable Society "Mother Teresa"		
Postal address: str. Mujë Krasniqi n.n. Ulpiana U1/1		
Town: Prishtina	Postal code: 10000	Country: Kosovo
Contact point(s): Zef Shala	Telephone: 038-542-865	
Email: zefshala@hotmail.com	Fax: 038-542-869	
Internet address (if applicable):	www.matherteresasociety.com	

**SECTION II: OBJECT OF THE CONTRACT**

**II.1) DESCRIPTION**

II.1.1) Contract title attributed by the contracting authority: Need Assessment for 400 previous beneficiaries		
II.1.2) Type of contract and location of works, place of delivery or of performance (Choose one category only - works, supplies or services - which corresponds to the main part of the specific object of your contract)		
		<input checked="" type="checkbox"/> Services
II.1.5) Short description of the object of the contract Need Assessment for 400 previous beneficiaries		
II.1.6) Common Procurement Vocabulary classification (CPV) 93.000.000.-8		
II.1.7) Variants are accepted		
		No <input checked="" type="checkbox"/>
II.1.8) Division into lots		
		No <input checked="" type="checkbox"/>
II.1.11) Estimated contract value: 16,000.00		

**II.2) QUANTITY OR SCOPE OF THE CONTRACT**

**II.3) DURATION OF THE CONTRACT OR TIME LIMITS FOR COMPLETION**

Duration in months 3 month or days 90 (from the contract signature)
Starting 15/12/2020
Completion 20/02/2021

**SECTION III: LEGAL, ECONOMIC, FINANCIAL AND TECHNICAL INFORMATION**

**III.1) CONDITIONS RELATING TO THE CONTRACT**

III.1.1) Performance security required	No <input checked="" type="checkbox"/>
III.1.2) Legal form to be taken by grouping of economic operators to whom the contract is to be awarded (if applicable)	
III.1.3) Other particular conditions to which performance of the contract is subject	No <input checked="" type="checkbox"/>

**III.2) CONDITIONS FOR PARTICIPATION**

III.2.1) Eligibility Requirements: 1. Certificate of Registration 2. Fiscal Number Registration 3. VAT-Certificate if applicable Documentary evidence required Copy of documentary
III.2.2) Professional Suitability: 1. Business Registration Certificate 2. List of Employees professional and administrative staff Documentary evidence required: Copy of documentary
III.2.3) Economic and financial capacity n/a
III.2.4) Technical and professional capacity CVs of relevant staff (including managerial staff, experts and administrative staff)

**III.3) CONDITIONS SPECIFIC TO SERVICE CONTRACTS**

III.3.1) Execution of services is reserved to a particular profession	No <input checked="" type="checkbox"/>
III.3.2) Legal persons should indicate the names and professional qualifications of the staff responsible for the execution of the service	Yes <input checked="" type="checkbox"/>

**SECTION IV: PROCEDURE**

**IV.1) TYPE OF PROCEDURE**

IV.1.1) Type of Procedure	<input checked="" type="checkbox"/> Open
---------------------------	--

**IV.2) AWARD CRITERIA**

<input checked="" type="checkbox"/> Lowest price
--

**IV.3) ADMINISTRATIVE INFORMATION**

IV.3.1) Previous publications concerning the same contract	No <input checked="" type="checkbox"/>
IV.3.2) Conditions for obtaining tender dossier	
Time limit for receipt of requests for tender dossier: date 23/11/2020	
IV.3.3) Time limit for additional Information Date 27.11.2020 time 14:00	
Payable documents	No <input checked="" type="checkbox"/>
IV.3.3) Time limit for receipt of tenders date 05/12/2020 time 12:00 place Prishtina	
IV.3.4) Time limits is shortened for submission of tenders	<input checked="" type="checkbox"/> no
IV.3.5) Is tender security needed:	No <input checked="" type="checkbox"/>
IV.3.6) Tender validity period: date: 05/12/2020 days 30 or months 1	
IV.3.7) Tender opening meeting: Date 05/12/2020 time 14:00 place Prishtina	

**SECTION V: COMPLEMENTARY INFORMATION**

**V.1) COMPLAINTS**

Any interested party may file a complaint with the Contracting Authority according to article 108/A of the Law No. No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092, at the address specified in Section I of this Contract notice.

**V.2) ADDITIONAL INFORMATION**

Note: Economic operators will be entitled to submit a tender, request to participate and other documents required or permitted to be filed during the conduct of a procurement activity in Albanian, Serbian or English.

**Republika e Kosovës**  
Komuna e Malishevës

**DREJTORIA PËR ARSIM DHE EDUKIM**

Adresa : Malishevë  
Rr. "Skënderbeu", p.n.  
Email: dkaemalisheva@gmail.com  
Tel: 029-269-003

Nr. 11/ \_\_\_\_\_

Data: 16.11.2020

PRANUAR MË  
ACCEPTED ON: 16.11.2020

PRIMLJENO:  
11.10999

Njoftim për anulimin e Konkursit me nr: Nr .11/1060 datë: 09.11.2020

Anulohet Konkursi i shpallur më Nr .11/1060 datë: 09.11.2020 për SHFMU " 17 Shkurti" në Begaj për 10 orë biologji, të shpallur në gazetën ditore

Anulimin i konkursit për këtë shkollë mbështetet në Vendimin e Sektorit të Inspeksionit të Arsimit në Gjakovë datë: 12.11.2020 me nr. 245/10/07

Drejtori i DKA-së  
Blerim Thaçi

**Invitation for Bids**

Ministry of Education and Science  
Project Title: Education Systems Improvement Project (ESIP)  
IDA, Credit No 57260 - XK  
Contract/Bid No. **3.13/G-ICB/ESIP- Purchase of the Tablets**

- The Ministry of Education and Science in Kosovo has received financing from the World Bank toward the cost of the Education Systems Improvement Project (ESIP) and it intends to apply part of the proceeds toward payments under the contract for Purchase of Tablets.
- The MES now invites sealed bids from eligible bidders for the Purchase of the Tablets: The delivery period is maximum 60 days after contract signature.
- Bidding will be conducted through the International Competitive Bidding (ICB) procedures as specified in the World Bank's *Guidelines: Procurement under IBRD Loans and IDA Credits*, January 2011, revised July 2014 and is open to all eligible bidders as defined in the guidelines.
- Interested eligible bidders may obtain further information from and inspect the bidding documents from the Ministry of Education and Science at the address stated at the end of document during office hours, *i.e. 08:00 to 16:00 hours*.
- A complete set of bidding documents in English may be obtained free of charge by interested bidders on the submission of a written application to the e-mail address below.
- Bids must be delivered to the address below on or before **by 14:00 hours on December 16, 2020**. Electronic bidding will **not** be permitted. Late bids will be rejected. Bids will be publicly opened in the presence of the bidders' designated representatives and anyone who choose to attend at the address below:  
Attention: ESIP Project  
Ministry of Education and Science  
Office number 309, Ministry Building  
Street: St. Agim Ramadani, n.n  
City: 10000 Prishtina  
Country: Kosovo
- All bids must be accompanied by a bid security for: **8,000.00 euro**, or an equivalent amount in a freely convertible currency.
- The address (es) referred to above is(are):  
ESIP Project  
Ministry of Education and Science  
Office number 309, Ministry Building  
Street: St. Agim Ramadani, n.n  
City: 10000 Prishtina  
Country: Kosovo  
Email: [esip.procurement@gmail.com](mailto:esip.procurement@gmail.com)

**NJOFTIM**

Njoftojme te gjithë klientet se Kompania "T&T" shpk me seli ne Prizren, ka marre vendim te shuaj biznesin me numer te regjistrimit : 810970823 dhe ka caktuar likuidatorin per zhvillimin e procedurës se Likuidimit. Njoftohen te gjithë klientet qe kane raporte Kreditore-Debitore ne kete shoqeri qe te paraqiten ne afatin 30 ditore nga data e shpalljes ne gazete.

**OBAVESTENJE**

Obaveštavamo sve kupce da je kompanija "T&T" shpk sa sedištem u Prizrenu, odlučila da zatvori posao sa registracijskim brojem: 810970823 i imenovala likvidatora za razvoj postupka likvidacije. Obaveštavaju se svi klijenti koji imaju kreditno-debitne izveštaje u ovoj kompaniji da se pojave u roku od 30 dana od dana objavljivanja u novinama.

**ANNOUNCEMENT**

We inform all customers that the company "T&T" shpk based in Prizren, has decided to close the business with registration number: 810970823 and has appointed the liquidator for the development of the Liquidation procedure. All clients who have Credit-Debit reports in this company are notified to appear within 30 days from the date of publication in the newspaper.

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- Shkelzen Gashi shpall te pa vlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV dhe diplomën e Sh.M.Teknike "Nexhmedin Nixha" ne Gjakovë.
- Fisnik Mamusha shpall te pa vlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV dhe diplomën e Sh.M.E. " Kadri Kusari " ne Gjakovë.
- Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.
- Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.
- Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qerimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.



Republika e Kosovës  
 Republika Kosova-Republic of Kosovo  
 Qeveria - Vlada-Government  
 Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrasnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs

Ministria e Punëve të Brendshme duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-076 për Policinë dhe Udhëzimin Administrativ nr. 13/2012-MPB për Themelimin, Përbërjen dhe Procedurat e Komisionit për Emërime të Larta në Polici, shpall:

**KONKURS**

**Titulli i postit: Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës**

**Referenca: MPB-DP/01**

**Kohëzgjatja:** Pesë (5) vjeçare, me mundësi të vazhdimet pas çdo pesë (5) vjetëve nga autoriteti që e emëron.

**Vendi i punës:** Prishtinë

**Raportimi:** Drejtori i Përgjithshëm i raporton dhe i përgjigjet drejtpërdrejt ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme për administrimin dhe menaxhimin e Policisë së Kosovës.

**Niveli i pagës:** Sipas ligjit në fuqi

**Orari i punës:** I plotë

**Përgjegjësi për Menaxhim ekzekutiv:** Po

**Funksionet dhe përgjegjësitë:**

- Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës është përgjegjës që të udhëheqë, të kontrollojë dhe të mbikëqyrë Policinë e Kosovës, të menaxhojë dhe të shpërndajë buxhetin e policisë në përputhje me objektivat dhe qëllimet strategjike të përcaktuara nga Ministri i MPB-së;
- Siguron zbatimin e politikave të Ministrisë së Punëve të Brendshme për Policinë e Kosovës;
- Ofron këshilla të paanshme profesionale për çështjet administrative për Ministrin, si dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me Policinë e Republikës së Kosovës;
- Struktura e brendshme organizative e Policisë së Republikës së Kosovës, propozohet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe aprovohet nga ministri i MPB-së;
- Me miratimin e ministrit të MPB-së, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës mund të themelojë njësi policore të përkohshme për të kryer detyra të veçanta;
- I ofron Ministrin informata dhe raporte për Policinë e Kosovës sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;
- Zbaton politika jo diskriminuese për stafin e Policisë, përfshirë përfaqësimin e barabartë gjinor në të gjitha fushat dhe nivelet dhe siguron përfaqësim shumetnik të personelit;
- Kryen punë të tjera të parapara me ligj, rregullore, apo udhëzime dhe urdhra të ligjshme.

**Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera që kërkohen:**

- Shkathësitë e dëshmuara të të menduarit strategjik, planifikimit dhe zbatimit;
- Të ketë aftësi të koordinimit dhe kontrollimit;
- Aftësia e dëshmuar për analizimin e nevojave për aftësim, përcaktimin e zgjidhjeve të duhura, monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së intervenimeve;
- Të ketë shkathësi të shkëlqyeshme të organizimit, duke punuar në një ambient nën presion;
- Të ketë shkathësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit me shkrim dhe me gojë;
- Të ketë aftësi të shkëlqyeshme të menaxhimit dhe negocimit;
- Të ketë aftësi për punë ekipore.

**Kualifikimet e kërkuara:**

- Diplomë universitare nga një universitet i akredituar ose të ketë diplomë të nostrifikuar;
- Kandidati/ja duhet të njohë mirë ndonjërin nga gjuhët zyrtare në shkrim dhe lexim, ndërsa njohja e gjuhës angleze është përparësi.

**Kushtet e veçanta:**

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të mos ketë qenë i dënuar për vepër penale, me vendim të formës së prerë;
- Të mos jetë i ndëshkuar për shkelje të rëndë disiplinore sipas rregullores disiplinore të policisë apo rregullores së institucioneve tjera shtetërore brenda dhjetë (10) vjetëve të fundit që është ekuivalente me shkeljet që përcaktohen në rregulloren e disiplinës së Policisë së Kosovës;
- Të ketë gradën policore kolonel, nënkolonel ose major, së paku pesë (5) vjet;
- Secili kandidat duhet të mos ketë konflikt interesi me detyrën apo si parashihen me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike;

- Secili kandidat për këtë pozitë, duhet t'i nënshtrohet verifikimit të sigurisë sipas ligjit të aplikueshëm;
- Kandidatët duhet të ofrojnë një letër interesi lidhur me motivet që e shtynë kandidatin për të konkurruar, si dhe CV-në e tij.

**Mënyra e aplikimit:**

Formularët për aplikim mund të merren në recepcion të MPB-së, ose të tërhiqen nga web faqja e MPB-së, ku është bërë edhe shpallja e konkursit, në adresën www.mpb-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin e Burimeve Njerëzore, ose nëpërmjet postës elektronike (ahmet.sh.gashi@rks-gov.net) dhe postës, në adresën: Divizioni i Burimeve Njerëzore, Rr. Luan Haradinaj p. n (afër stadiumit) Prishtinë, çdo ditë punë nga ora 8:00 -16:00.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore dhe në Web faqen e MPB-së, duke filluar nga data 18.11.2020 deri më 02.12.2020.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni me z. Ahmet Gashi, nr. tel. 038-200 19 548.



**Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten:** kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit për kualifikim të studimeve themelore, dëshmi mbi gradën Major, Nënkolonel apo Kolonel për 5 vjet, Certifikatën nga evidenca e personave kundër të cilëve është duke u zhvilluar procedura penale dhe personave të dënuar nga Gjykata, dëshmi nga institucioni kompetent që nuk është i ndëshkuar për shkelje të rëndë disiplinore në dhjetë (10) vjetet e fundit, deklaratë nga kandidati me të cilën deklorohet se nuk ka konflikt interesi me detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, ashtu siç parashihet në Ligjin për Policinë e Kosovës dhe Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksioneve publike, deklaratë e cila duhet të ketë datën dhe nënshkrimin e deklaruesit.

Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhje të ngushtë, do të informohen lidhur me intervistën nëpërmjet telefonit ose me shkrim (në afat ligjor), nga personeli i Divizionit të Burimeve Njerëzore.

Kandidatët që posedojnë certifikatën e sigurisë, të ia bashkëngjisin një kopje të saj aplikacionit.

Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë, duhet të sjellin për shikim (konfirmim) të gjitha dokumentet origjinale. Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të mbylljes së shpalljes nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.

Ministria e Punëve të Brendshme i shërben gjithë popullit të Kosovës. Ajo i inkurajon aplikacionet prej femrave dhe meshkujve, dhe pa dyshim, inkurajon të gjitha grupet etnike minoritare në Kosovë.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government  
Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo unutrašnjih poslova / Ministry of  
Internal Affairs

Ministarstvo unutrašnjih poslova na osnovu Zakona br. 04 / L-076 o policiji i Administrativnog upustva br. 13/2012-MUP o osnivanju, sastavu i procedurama Komisije za viša policijska imenovanja, objavljuje:

## KONKURS

**Naziv posta:** Generalni direktor Kosovske policije

**Referenca:** MUP-DP / 01

**Trajanje:** pet (5) godina sa mogućnošću obnavljanja svakih pet (5) godina od strane organa za imenovanja

**Mesto:** Priština

**Izveštavanje:** Generalni direktor izveštava i odgovara direktno ministru unutrašnjih poslova za administraciju i upravljanje policijom

**Nivo plate:** Prema važećem zakonu

**Radno vreme:** Puno

**Odgovornost izvršnog rukovodstva:** Da

**Funkcije i odgovornosti:**

1. Generalni direktor policije je odgovoran za vođenje, kontrolu i nadzor policije, upravljanje i raspodelu budžeta policije u skladu sa strateškim ciljevima koje odredi ministar;
2. Garantuje sprovođenje politika Ministarstva unutrašnjih poslova za Kosovsku policiju;
3. Pruža ministru nepristrasne profesionalne savete o administrativnim pitanjima, kao i druga pitanja koja se odnose na policiju;
4. Unutrašnju organizacionu strukturu Policije Republike Kosovo predlaže generalni direktor i odobrava ministar;
5. S odobrenjem ministra može osnovati privremene jedinice policije za obavljanje posebnih zadataka;
6. Pruža informacije i izveštaje ministru o Kosovskoj policiji kako je utvrđeno Zakonom;
7. Primeni nediskriminativnih politika za policijsko osoblje, uključujući ravnopravnu zastupljenost polova u svim oblastima i nivoima i garantuje zastupanje multietničkog osoblja;
8. Obavlja i druge poslove propisane zakonom, pravilnicima ili uputstvima.

**Potrebne veštine, iskustvo i drugi atributi:**

- Dokazane veštine o strateškom mišljenju, planiranju i implementaciji;
- Veštine za koordinaciju i kontrolu;
- Dokazana sposobnost za analiziranje potreba za obukom, određivanje odgovarajućih rešenja, praćenje i ocenjivanje kvaliteta intervencije;
- Odlične sposobnosti za organizaovanje, radeći u okruženju pod pritiskom;
- Dokazane i efikasne veštine u pisanoj i usmenoj komunikaciji;
- Pdlične lične menadžerske veštine i veštine pregovaranja;
- Posedovanje veština za timski rad.

**Potrebne kvalifikacije:**

- Univerzitetska diploma sa akreditiranog univerziteta ili diplomu sertifikovanog;
- Kandidat treba da zna jedan od službenih jezika u pisanju i čitanju, a prepoznavanje engleskog jezika je prednost.

**Posebni uslovi:**

- Da bude državljanin Republike Kosova;
- Da ne bude osuđen za krivično delo konačnom odlukom;
- Da ne bude kažnjen za teške disciplinske prekršaje prema disciplinskim propisima policije ili propisima drugih državnih institucija u poslednjih deset (10) godina, što je ekvivalentno krivičnim delima utvrđenim u propisu o disciplini Kosovske policije;
- Imati čin pukovnika, potpukovnika ili poručnika najmanje pet (5) godina;
- Svaki kandidat ne bi trebao imati sukob interesa sa zadatkom ili kao što je predviđeno Zakonom o sprečavanju sukoba interesa u vršenju javnih funkcija;
- Svaki kandidat za ovu poziciju podleže proveru sigurnosti prema važećem zakonu;

Kandidati bi trebali dati pismo od interesa u vezi sa motivima koji su doveli kandidata da se takmiči, kao i njegov CV.

**Način konkurisanja:**

Obrasci za konkurisanje se mogu uzeti na recepciji MUP-a u Prištini ili da se izvuku sa web stranice MUP-a gde je i objavljen konkurs, na adresi [www.mpb-rks.org](http://www.mpb-rks.org) i predaju se u Kancelariji za ljudske resurse, ili elektronskom poštom ([ahmet.sh.gashi@rks-gov.net](mailto:ahmet.sh.gashi@rks-gov.net), ili poštom na adresi: Divizija za ljudske resurse, Ul. Luan Haradinaj, b.b. (kod gradskog stadiona) Priština, svakog radnog dana od 8:00 - 16:00.

Konkurs je otvoren 15 dana nakon objavljivanja u dnevnim novinama od 18.11.2020 do 02.12.2020.

Za dodatne informacije kontaktirajte g. Ahmet Gashi, br. tel. 038/200 19 548.

Aplikaciji treba priložiti: fotokopiju lične karte, kopije dokumentacije za kvalifikacije osnovnih studija, dokaza vojne čin majora, potpukovnika ili pukovnika za pet godina, Uverenje o licima protiv kojih se vodi krivični postupak i osuđenih od suda, dokazi iz nadležne institucije da nije kažnjen za težeg disciplinskog prekršaja u deset (10) zadnjih godina, izjava od kandidata kojom izjavljuje da ne postoji sukob interesa sa pozicije generalnog direktora Kosovske policije, kao što je predviđeno u Zakonu o policiji i Zakon o sprečavanju sukoba interesa u vršenju javnih funkcija, izjavu koja mora imati datum i potpis u deklaraciju.

Kandidati koji ulaze u bliskoj selekciji biće obavešteni o intervjuu telefonom ili pismenim putem u zakonskom roku od strane osoblja odeljenja za ljudske resurse.

Kandidati koji poseduju sigurnosni sertifikat pripisuju njegovu kopiju aplikaciji. Kandidati koji će biti izabrani i pozvani na intervju trebalo bi da daju sve originalne dokumente na uvidu (potvrdu). Zahtjevi poslani nakon poslednjeg datuma objavljivanja oglasa neće biti prihvaćeni. Nepotpuni zahtevi mogu biti odbijeni.

Ministarstvo unutrašnjih poslova služi svim ljudima Kosova. Ona podstiče apliciranje žena i muškaraca, i bez sumnje sve manjinske etnike grupe na Kosovu.



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

**Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:**

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](https://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

---

# SWISS

## TAVERNA

---

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

